




Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo / Republika Kosova  
Komuna e Prishtinës  
Municipality of Prishtina / Opstina Pristina



## Plani Rregullues Urban “MEDRESE-ÇAMËRI”-Prishtinë




Prishtinë, Nëntor 2012



Republika e Kosovës  
Republic of Kosovo / Republika Kosova  
Komuna e Prishtinës  
Municipality of Prishtina / Opstina Pristina






**AUTOR:**

|   |   |
|---|---|
| <i>Porositës:</i>                                 | Komuna e Prishtinës   |
| <i>Koordinator:</i>                               | Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit   |
| <i>Menaxher i projektit nga ana e Komunës:</i>    | ark. Muhamet MORINA, i.d.   |
| <i>Hartues:</i>                                   | “Hidroing-DK”, sh.p.k.  |
| <i>Bashkëpunetorë i jashtëm:</i>                  | ark. Dukagjin HASIMJA, i.d. nr.lic. 152-1-658/ 89<br>ark. Bujar DEMJAHA, i.d. nr.lic. 152-1-241/ 87 |
| <i>Menaxher i Projektit:</i>                      | ark. Valentin GJ. JUNÇAJ, i.d.  |
| <i>Projektues:</i>                                | ark. Valentin GJ. JUNÇAJ, i.d.<br>m.ark. Egzon BAJRAKTARI<br>ark. Orhan MORINA, i.d.                |
| <b>PROJEKTUES TË FAZAVE:</b>                      |   |
| <i>Profili Urban - anketimi i ban.:</i>           | Studentët nga Universiteti i Prishtinës   |
| <i>Komunikacioni:</i>                             | Mr.sc.Visar BAXHUKU i.d.kom.  |
| <i>Instalimet elektrike dhe telefonike:</i>       | Mr.sc.Gani LATIFI, i.d.e.   |
| <i>Instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit:</i> | Zarife SALLAHU, i.d.h.  |
| <i>Instalimet e ngrohjes:</i>                     | Sherif GASHI, i.d.m.  |
| <i>Rregullimi i sipërfaqeve të gjelbëruara:</i>   | ark. Orhan MORINA, i.d.   |
| <i>Demografia:</i>                                | Mr.sc. Elvana BERISHA gjeog.  |
| <i>Mjedisi:</i>                                   | dr. Sc. Sylejman BERISHA i.d.   |
| <i>Databaza:</i>                                  | Arianit BERISHA, IT   |
| <i>Inçizimi gjeodezik:</i>                        | Qemail HODA, i.d.gj.  |
| <i>Drejtör:</i>                                   | Eta MORINA  |

---




## PËRMBAJTJA:

### DOKUMENTACIONI I KOMPANISË PROJEKTUESE

#### A. PJESA TEKSTUALE

|        |  |     |
|--------|--|-----|
| 1      | HYRJE .....  | 9   |
| 2      | KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR TË LAGJES .....   | 10  |
| 2.1    | Objektivat .....   | 10  |
| 2.2    | Vizioni.....   | 10  |
| 2.3    | Programi.....  | 10  |
| 3      | PLANI RREGULLUES URBAN.....  | 11  |
| 3.1    | Kufijtë e zonës për të cilën hartohet plani dhe shenjzimet e tyre në hartat kadastrale .....   | 11  |
| 3.2    | Gjendja ekzistuese .....   | 13  |
| 3.2.1  | Profili Urban .....  | 13  |
| 3.2.2  | Pamje nga lagjeja .....  | 14  |
| 3.2.3  | Përparësitë dhe Mangësitë e lagjes në gjendjen ekzistuese.....   | 15  |
| 3.3    | Destinimi i sipërfaqeve .....  | 16  |
| 3.3.1  | Plani Strategjik 2004-2020.....  | 16  |
| 3.3.2  | Destinimi i sipërfaqeve .....  | 17  |
| 3.3.3  | Ndarja e tërësive dhe blloqeve urbane.....   | 18  |
| 3.4    | Vijat rregullative të rrugëve dhe sipërfaqeve publike si dhe vijat ndërtimore ....   | 23  |
| 3.5    | Pikat e lartësisë së rrugëve dhe sipërfaqeve publike (plani i nivelimit).....  | 24  |
| 3.6    | Zgjidhja e rrjetit të infrastrukturës: rrugëve, furnizimit me ujë, ujërave të zeza, ujërave atmosferike, telekomunikimet, elektricitetit, etj. dhe kyçjet në infrastrukturë .. | 24  |
| 3.6.1  | Rrjeti rrugor - transporti .....   | 24  |
| 3.6.2  | Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit .....  | 39  |
| 3.6.3  | Rrjeti elektroenergjetik dhe telekomunikues .....  | 41  |
| 3.6.4  | Sistemi i ngrohjes.....  | 44  |
| 3.7    | Plani i parcelimit dhe riparcelimit.....   | 46  |
| 3.8    | Normat dhe standardet teknike për zhvillimin urban duke përfshirë shkallën e planeve .....   | 48  |
| 3.8.1  | Bilansi i sipërfaqeve sipas PRrU Medrese-Çamëri.....   | 48  |
| 3.9    | Kushtet Urbanistiko-teknike të blloqeve.....   | 50  |
| 3.9.1  | Teresia A.....   | 56  |
| 3.9.2  | Teresia B .....  | 87  |
| 3.9.3  | Teresia C.....   | 100 |
| 3.10   | Kushtet dhe kriteret për mbrojtje mjedisore .....  | 121 |
| 3.10.1 | Kushtet dhe kriteret për mbrojtjen e mjedisit jetësor .....  | 121 |
| 3.10.2 | Kushtet për lëvizje të lirë për personat me aftësi të kufizuara .....  | 121 |
| 3.11   | Kushtet dhe kriteret për shfrytëzim racional të energjisë .....  | 121 |
| 3.12   | Kushtet urbane për sipërfaqet publike, private si dhe elementet përcjellëse ..   | 122 |
| 3.12.1 | Sipërfaqja e lirë publike .....  | 122 |




|        |  |     |
|--------|--|-----|
| 3.13   | Kërkesat e veçanta, kushtet dhe rregulloret e domosdoshme për lëshimin e lejes ndërtimore, sipas vendit dhe llojit të objektit që është duke u ndërtuar.....   | 124 |
| 3.14   | Vlerat me rëndësi natyrore, kulturore, historike si dhe identifikohen objektet për të cilat është e domosdoshme të sigurohet mbrojtje ose kushte të tjera të veçanta para fillimit të renovimit apo rikonstruimit të tyre..... | 125 |
| 3.14.1 | Vlerat me rëndësi natyrore, kulturore, historike.....  | 125 |
| 3.14.2 | Objektet në mbrojtje.....  | 125 |
| 3.15   | Kushtet në lidhje me mbrojtjen mjedisore nga lloje të ndryshme të ndotjes, mbrojtja e biodiversitetit, mbrojtja nga zjarri dhe fatkeqësitë e tjera, si dhe shkatërrimet.....   | 126 |
| 3.15.1 | Kushtet për mbrojtje nga lloje të ndryshme të ndotjes .....  | 126 |
| 3.15.2 | Kushtet për mbrojtje nga zjarri, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera  | 126 |
| 3.16   | Lloji dhe karakteri i objektit që mund të ndërtohet nën kushtet e përcaktuara me plan ose nën kushte të veçanta.....   | 127 |
| 3.16.1 | Kushtet e përgjithshme për vendosje të ndërtesave të përkohshme....  | 127 |
| 3.16.2 | Kushtet për vendosjen e ndërtesave.....  | 127 |
| 3.17   | Lloji dhe shfrytëzimi i objektit, ndërtimi i së cilit është i ndaluar në zona të caktuara.....   | 131 |
| 3.18   | Pozita e objektit në parcelë dhe në kuadër të parcelave fqinje .....   | 131 |
| 3.19   | Lartësia e objekteve.....  | 134 |
| 3.20   | Distanca më e vogël ndërmjet objekteve .....   | 134 |
| 3.21   | Kushtet për ndërtimin e objekteve të tjera në parcelën e njëjtë ndërtimore ...   | 134 |
| 3.21.1 | Kushtet për ndërtimin e objekteve tjera .....  | 134 |
| 3.21.2 | Kushtet për vendosje të elementeve mikro-urbane.....   | 135 |
| 3.22   | Kushtet dhe mënyrat e sigurimit të hyrjes në parcelë dhe në hapësirën e parkingut .....  | 135 |
| 3.23   | Kushtet për definimin e rrethojave.....  | 136 |
| 3.24   | Formësimi arkitektonik dhe estetik i elementeve të caktuara të objektit (materialeve, fasadave, kulmeve, etj.) .....   | 136 |
| 3.25   | Kushtet për renovim dhe rikonstruim të objekteve ekzistuese .....  | 137 |
| 3.25.1 | Ndërtesat ekzistuese në parcelë.....   | 137 |
| 3.25.2 | Intervenimet në ndërtesa .....   | 137 |
| 3.25.3 | Objektet që atakojnë rrugët .....  | 137 |
| 3.26   | Kushtet e veçanta për ndërtim të objekteve .....   | 139 |
| 3.27   | Dendësia e banimit dhe dendësia e ndërtimit sipas standardeve.....   | 139 |
| 3.27.1 | Shtimi demografik i lagjes.....  | 139 |
| 3.28   | Kushtet që kanë të bëjnë me hapësirat e lira të cilat duhet të mirëmbahen në apo përreth ndërtesave .....  | 140 |
| 3.28.1 | Rregullimi i hapësirave të lira / gjelbrimit.....  | 140 |
| 3.29   | Kushtet e kyçjes në infrastrukturë (p.sh. furnizimi me ujë, menagjimi i hedhurinave të ngurta, hapësirat për parkingje, etj.) .....  | 142 |
| 3.30   | Kushtet për vendosjen e objekteve tregtare, punëtorive, depove apo fabrikave .....   | 143 |



|       |   |     |
|-------|---|-----|
| 3.31  | Kushtet për vendosjen e objekteve me karakteristika të veçanta arkitektonike të dizajnuara për qëllime të veçanta ..... | 143 |
| 3.32  | Kushtet për ndërtimin e objekteve me rëndësi strategjike .....  | 144 |
| 4     | VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS - VNM.....   | 145 |
| 4.1   | Infrastruktura ligjore në fushën e mjedisit.....  | 145 |
| 4.2   | Mbrojtja e ajrit.....   | 145 |
| 4.3   | Rrjeti I furnizimit me ujë, rrjeti I kanalizimit.....   | 145 |
| 4.4   | Trajtimi I mbeturinave.....   | 145 |
| 4.5   | Mbrojtja nga zhurma.....  | 146 |
| 4.6   | Mbrojtja nga zjarri.....  | 146 |
| 4.7   | Mbrojtja e njerëzve.....  | 147 |
| 5     | DISPOZITAT E IMPLEMENTIMIT.....   | 148 |
| 5.1   | Dispozitat e përgjithshme e rregullimit .....   | 148 |
| 5.1.1 | Ndarja në tërësi urbane.....  | 148 |
| 5.2   | Dispozitat lidhur me përgjegjësitë, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen .....  | 148 |
| 5.3   | Dispozitat e fundit dhe kalimtare .....   | 149 |
| 5.3.1 | Aprovimi i planit.....  | 149 |
| 5.3.2 | Vlefshmëria .....   | 149 |
| 6     | PARAMASA DHE PARALLOGARIA E INFRASTRUKTURËS.....  | 150 |
| 6.1   | Sistemi Rrugor.....   | 150 |
| 6.2   | Sistemi i Ngrohjes .....  | 151 |
| 6.3   | Rrjeti ElektroENERGJETIK.....   | 152 |
| 6.4   | ujësjellësi dhe kanalizimi .....  | 153 |
| 6.5   | rekapitulimi.....   | 154 |

## B. PJESA GRAFIKE

- Harta 1. Ekstrakt nga Plani Strategjik
- Harta 2. Plani Kadastral
- Harta 3. Kategorizimi i rrugëve
- Harta 4. Profilet e Rrugëve
- Harta 5. Objektet që atakojnë rrugët
- Harta 6. Zgjidhja Urbane
- Harta 7. Riparcelimi
- Harta 8. Ujësjellësi
- Harta 9. Kanalizimi Fekal dhe atmosferik
- Harta 10. Rrjeti Elektroenergjetik
- Harta 11. Sistemi i Ngrohjes




## Lista e Shkurtesave


|          |   |
|----------|---|
| PRrU     | Plani Rregullues Urban                              |
| PZhS     | Plani zhvillimorë Strategjik                        |
| KKP      | Kuvendi Komunal Prishinë                            |
| KP       | Komuna e Prishtinës                                 |
| KEK      | Korporata Energjetike e Kosovës                     |
| PTK      | Posta dhe Telekom i Kosovës                         |
| ISHP     | Indeksi i shfrytëzimit të parcelës                  |
| ISD      | Indeksi i sipërfaqes së dyshemesë                   |
| V.RR.    | Vija rregulluese                                    |
| V.N.     | Vija ndërtimore                                     |
| SBB      | Sipërfaqja Bruto e bllokut                          |
| SNB      | Sipërfaqja Neto e bllokut                           |
| P.K.     | Parcelimi Kadastral                                 |
| N. ng.   | Numri i ngastrës (parcelës)                         |
| SP.      | Sipërfaqja e përdhësës                              |
| SK.      | Sipërfaqe komerciale                                |
| I.       | Infrastruktura                                      |
| Nr. B.   | Numri i banorëve                                    |
| Nr. F.   | Numri i fëmijëve                                    |
| Nr. b/ha | Numri i banorëve për hektar                         |
| ZM       | Zonë mikse (e përzier)                              |
| KP       | Konzervuar Publik                                   |
| KB       | Konzervuar banim                                    |
| IMMR     | Instituti i monumenteve dhe muzeu rajonal Prishtinë |



DOKUMENTACIONI I KOMPANISË PROJEKTUESE







|   |  |
|---|--|
| <p><b>1. PROJEKTUES URBANIT</b></p> <p>a. Shprehja e shprehjes së planit urbanistik të bashkisë<br/> b. 1 - Plani rregullues i përgjithshëm për qytetin e bashkisë<br/> 2 - qytet<br/> c. Niveli i planit urbanistik</p>  | <p><b>2. PROJEKTUES ARIKËT</b></p> <p>a. Çfaqje civile - industriale - turistike deri 10 km<br/> b. Çfaqje civile - industriale - turistike më 10 km<br/> c. Çfaqje sportive<br/> d. Projekti i riutillit<br/> e. Projekti për rrugë, sisteme rregullimi të gjatësive, 1 tërheqje e punje</p>                |
| <p><b>3. PROJEKTUES KONSTRUKTOR</b></p> <p>a. Çfaqje civile - industriale - turistike prej secilit 1 deri në 10 km<br/> b. Çfaqje civile - industriale - turistike<br/> 1. Prej 1 deri 5 km<br/> 2. Mbi 5 km<br/> c. 1. Çfaqje me shprehje të fortë urbanistikë dhe urban - turistike - 1. deri dhe sipas sec. gjatësive të rrugës</p>  | <p><b>4. PROJEKTUES PËRVEKTORE</b></p> <p>a. Instalime hidroenergetike<br/> b. Instalime termike - termike - hidroenergetike<br/> c. Lloje të reja instalime - hidroenergetike - termike - instalime - instalime<br/> d. Sisteme komplekse të instalimeve termike<br/> e. Sisteme të instalimeve të reja</p> |
| <p><b>5. PROJEKTUES VEPRË HIDRAULIKE</b></p> <p>a. Digje - gjatës - kanale hidroenergetike<br/> b. Transmisione të ujërave - instalime hidroenergetike<br/> c. Instalime hidroenergetike të reja - kanale<br/> d. Vepra të reja - kanale - instalime - digje deri 10 km - kanale<br/> e. Vepra të reja të ujërave<br/> f. Vepra hidroenergetike, energji ujë, instalime - instalime - instalime - instalime<br/> g. Vepra hidroenergetike - instalime - instalime - instalime</p> | <p><b>6. PROJEKTUES RRUGË - DHEMORIE</b></p> <p>a. Rrugë auto kategorisë V dhe IV<br/> b. 1. Projekti i rrugës kategorisë III dhe II<br/> 2. Kategoritë I<br/> c. Sisteme rregullimi të rrugëve - instalime<br/> d. Instalime - instalime - instalime</p>  |
| <p><b>7. PROJEKTUES URAHË VEPRË AKTIVE</b></p> <p>a. Ura dhe vepra të reja të instalimeve apo instalimeve të reja të urave<br/> 1. Deri në 10 m<br/> 2. Mbi 10 m<br/> b. Ura dhe vepra të reja të instalimeve apo instalimeve të reja të urave<br/> 1. Deri në 10 m<br/> 2. Mbi 10 m<br/> c. Ura të reja, të përdorueshme</p>   |  |





## 1 HYRJE

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, në kuadër të Komunës së Prishtinës, kamarrë vendimpër hartimin e Planit Rregullues Urban për lagjen "Medrese-Çamëri" (mars 2009).

"Hidroing-DK" Shpk, studio e dizajnit dhe planifikimit urban, është angazhuar nga Komuna e Prishtinës për hartimin e këtij Plani Rregullues Urban sipas kontratës nr. 616 08 299 211 me dt. 25.03.2009 të lidhur në mes Komunës së Prishtinës dhe kompanisë projektuese.

Lagjja "Medrese-Çamëri" paraqet një lagje të ndërtuar kryesisht jashtë standardeve të planifikimit urbanistik dhe me probleme të mëdha të infrastrukturës teknike e sociale.

Nga ndërtimi i objekteve në mënyrë të pa kontrolluar sidomos në dymbëdhjetë vjetët e fundit ka rezultuar me një kaos urbanistik. Ndërtimet ekzistuese vështirësojnë intervenimin urbanistik për rregullimin e lagjes dhe furnizim me shërbimet e duhura të infrastrukturës teknike dhe sociale.

Me hartimin dhe aprovimin e Planit strategjik zhvillimor urbanistik të Prishtinës nga ana e Kuvendit të Komunës në vitin 2004, lagjja "Medrese-Çamëri" definohet si zonë mikse urbane (biznes dhe banim) dhe zonë kryesisht banimi.

Lagjja "Medrese-Çamëri" ndodhet në pjesën veri-lindore të Prishtinës dhe karakterizohet me dendësi të banimit të shtëpive të vogla individuale brenda parcelave të vogla urbane. Terreni ka pjerrësi të ulët.

Objektivi kryesor i PRRU është përcaktimi i normave dhe rregullave për të lehtësuar dhe qartësuar marrëdhëniet investitorë-pronarë-truall.

### ÇËSHTJET KRYESORE TË PLANIT


Dinamika e rritjes urbane në kontekstin aktual socio-ekonomik, paraqet një sfidë të madhe të përshtatjes të qytetit dhe mbi të gjitha infrastrukturës dhe sistemit të shërbimit ndaj nevojave të popullsisë duke integruar rritjen aktuale dhe të vazhdueshme të saj brenda një sistemi urban efikas dhe të qëndrueshëm.

Sfida shtrihet përtej zhvillimit fizik, ajo fokusohet në ri-ekuilibrimin e interesave publike e private në procesin e zhvillimit urban duke përshtatur këto role në kontekstin e një shoqërie të hapur e demokratike që bazohet në ekonominë e tregut të lirë.

Hartimi i PRRU Medrese Çamëri konform ligjit dhe standardeve bashkëkohore të planifikimit hapësinor është bërë me një proces gjithëpërfshirës – ku janë përfshirë qytetarët, përfaqësues të biznesit dhe institucioneve.

Përmbajtja e PRRUpërfshinë të gjitha elementet themelore të caktuara me Udhëzim Administrativ (nr.prot 02/05) për zbatimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor mbi elementet themelore të Planeve Rregulluese Urbane.

Plani rregullues përmban përshkrimin dhe analizën e gjendjes ekzistuese të zonës, konceptin ideor të zhvillimit hapësinor dhe propozimin detal për rregullimin e lagjes, pra dokumenti është bazë e informatave, rregullave dhe kushteve për rregullim të lagjes.



## 2 KORNIZA E ZHVILLIMIT HAPËSINOR TË LAGJES

### 2.1 OBJEKTIVAT

Qëllimi kryesor i PRrU të lagjes “Medrese-Çamëri” është zgjerimi gjegjësisht hapja e rrugëve të reja kryesore që do mundësojnë funksionimin e lagjes dhe të organizojë zhvillimin urban aktual. Zona do të zhvillohet bazuar në principet e qëndrueshme, në një zonë të përshtatshme për jetesë të shëndetshme, ambientale dhe aktive.

Për më tepër, Plani Rregullues Urbanistik i ka këto objektiva:

- Zhvillimin e një koncepti urban me zona të përziera dhe zona të banimi;
- Zhvillimi i një mjedisi të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm;
- Zhvillimi i infrastrukturës relevante shoqërore sikurse janë objektet edukativo-arsimore, qendrat për përkujdesje, shërbimet shëndetësore, etj.;
- Zhvillimi i infrastrukturës relevante teknike në zonë;
- Minimizimi i ndotjes së ajrit;
- Minimizimi i sasisë së ujit të shiut në sistemin e kanalizimit dhe promovimi i drenazhimit të ujit atmosferik duke i minimizuar sipërfaqet e mbyllura;
- Krijimi i rrugëve të reja dhe zgjerimi, rregullimi i rrugëve ekzistuese;
- Zhvillimi i rrugëve dhe udhëkryqeve në zonë në rrugë dhe sheshe atraktive urbane.
- Inkurajimi i jetës së shëndoshë në ambiente të shëndosha;

### 2.2 VIZIONI


Bazë për hartimin e PRrU të lagjes “Medrese-Çamëri” është Plani Strategjik Zhvillimor i Prishtinës. Sipas këtij plani kjo zonë trajtohet si zonë banimi dhe Zonë mikse urbane, pjesërisht e përzier për zhvillimin e veprimtarive ekonomike për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

### 2.3 PROGRAMI

Programi për Planin rregullues urbanistik të lagjës “Medrese-Çamëri” bazohet në rezultatet e Profilin Urban, qëllimet e planit rregullues si dhe rekomandimet e Planit Strategjik 2004-2020.

Me problematikën që ka, rregullimi i një zone të kësaj madhësie mund të marrë 10-15 vite, dhe nevojat e kërkesat në këtë zonë mund të ndryshojnë gjatë kësaj periudhe. Programi për rregullimin urbanistik të lagjes në fjalë parasheh zhvillimin e qëndrueshëm të saj duke përfshirë:

- Rregullimi i blloqeve urbanistike mikse / banimit individual / publike sipas standardeve bashkëkohore
- Sigurimi i infrastrukturës së nevojshme sociale (arsim, shëndetësi, kulturë, sport)
- Sigurimi i infrastrukturës së re komunale: ujësjellesi, kanalizimi, rryma elektrike, ngrohja qendrore, gasifikimi, interneti, telefonia tokësore, sistemi i rjetit kabllovik;
- Përmirësimi i infrastrukturës rrugore dhe rritja e numrit të parkingjeve;
- Qasje gjithpërfshirëse në të gjitha sektoret e komunitetit e në veçanti për persona me aftësi të kufizuara, pleq dhe fëmijë;
- Mbrojtja e fondit ekzistues të gjelbërimit dhe shtimi i hapësirave të gjelbëruara;



## 3 PLANI RREGULLUES URBAN

### Emri i planit

Emri i planit është "Plani Rregullues Urban për lagjen Medrese-Çamëri.

### Baza ligjore për planin

Plani Rregullues Urban i lagjes medrese-Çamëri është i bazuar në:

- Ligjin mbi Planifikim Hapësinor, Ligji nr 2003/14, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 3 Korrik 2003 me rregulloren Nr 2003/30 të 10 Shtatorit 2003
- Ligjin për ndryshimin e Ligjit mbi Planifikim Hapësinor nr 2003/14, Ligji nr 03/L-106 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 10 nëntor 2008
- Ligjin për ndërtim, Ligji Nr 2004/15, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 27 Maj 2004 me rregulloren Nr 2004/37 të 14 Tetorit 2004.
- Udhëzimin administrativ për zbatimin e ligjit për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të planit rregullues urban, dhe
- Udhëzuesi administrativ mbi procedurën e shqyrtimit publik për Planet Hapësinore dhe Urbanistike 54/2005

### 3.1 KUFIJTË E ZONËS PËR TË CILËN HARTOHET PLANI DHE SHENJËZIMET E TYRE NË HARTAT KADASTRALE

#### LOKACIONI

Komuna e Prishtinës ka 572 km<sup>2</sup>. dhe i ka gjithësej 48 fshatra. Lagjja "Medrese-Çamëri", ndodhet në pjesën verilindore të qytetit të Prishtinës.



Figura 1 Qyteti i Prishtinës dhe pozita e lagjes Medrese-Çamëria



## KUFIRI I PLANIT

Lagjja "Medrese-Çamëri" kufizohet:

- në Veri e tangjenton "Unaza e brendshme";
- në Lindje me lagjen "Vneshtat", përkatësisht me rr."Haxhi Zeka";
- në Jug me rr."Llapi", përkatësisht me zonën historike të qytetit; ndërsa
- në Perëndimpërkaj rr. "Bajram Bahtiri" hekurudha e kufizon me lagjen "Kodra e Trimave".

Kufiri i lagjes është paraqitur në pjesën grafike, harta 2 "Parcelimi kadastral".

## Vërejtje:

*Sipas kërkesës së Komunës së Prishtinës pas përfundimit të Profilit Urban kemi përfshirë edhe një hapësirë shtesë në Planin Rregullues të lagjes meqë ka ngelur e patrajtuar. Kjo hapësirë ka sipërfaqe prej 6.2ha për të cilën nuk janë bërë analizat dhe studimet përkatëse si për pjesën tjetër të lagjes por gjatë zgjidhjes urbane do të jetë edhe ajo pjesë e trajtuar.*

## SIPËRFAQJA E PLANIT

Plani përfshinë sipërfaqe prej 98.9ha.


## GJENDJA KADASTRALE

Hapësira e përfshirë me këtë plan rregullues është në kuadër të zonës urbane të Prishtinës. Lokacioni ka parcela të madhësive të ndryshme. Kartografia ekzistuese është shumë e varfër, meqë ka mungesë të madhe të informatave rreth pronave në përgjithësi në Kosovë por edhe në Prishtinë. Dokumentet në dispozicion që janë përdorur për këtë planjanë :

- planet kadastrale të vitit 1975 -të skanuara
- fotografia ajrore e Prishtinës e vitit 2009.

Harta e prezentuar është gjendja e fundit e kadastrit komunal Prishtinë, (tetor 2009)nga e cila informatë, për lagjen Medrese-Çamëria ka dalur ky raport i pronësisë:

- Pronë shoqërore-publike 26%
- Pronë private 74%



## 3.2 GJENDJA EKZISTUESE

### 3.2.1 Profili Urban

Struktura e ndërtuar – dominohet nga shtëpitë individuale të ndërtuara jashtë kriteve të planifikimit urbanistik, duke mos respektuar distancat mes njëra tjetres dhe duke përcjellur dhe njëkohësisht përkufizuar një rrjetë në masë të madhe të çrregullt të rrugëve.

Në këtë lagje janë evidentuar rreth 1900 objekte ekzistuese që zënë sipërfaqe të trullit prej 167.635 m<sup>2</sup> ndërsa sipërfaqja totale e ndërtimit është 302,756 m<sup>2</sup>. Dendësia urbane mesatare ekzistuese e lagjes në përdhese është ISHP= 0.20, ndërsa ndertimi total nëpër kate është ISD=0.37.

Tab.1Sipërfaqeve ekzistuese të ndërtimit

| PERMBAJTJA |   | Sip. (m <sup>2</sup> ) | Koeficienti i shfrytezimit |
|------------|---|------------------------|----------------------------|
| 1          | Sip. tot. e ndërtimit në Përdhese (m <sup>2</sup> ) | 167,635                | 0.20                       |
| 2          | Sip. tot. e ndërtimit nëpër Kate (m <sup>2</sup> )  | 302,756                | 0.37                       |


Kjo lagje e qytetit karakterizohet me dendësitë ultë banimore dhe kjo dendësi ka vlerën mesatare rreth 20 njësi banimi /ha.

Infrastruktura sociale e lagjes është e mbuluar mjaft mirë me shkollimin fillor dhe të mesëm të ultë me prezencën e tri shkollave të këtij rangu. Poashtu QMF plotëson në masën minimale shërbimet shëndetësore për lagjen. Mungesa e institucioneve parashkollore, hapësirave për rekreim etj. duhet të plotësohet me PRrU.

Rrugët paraqesin një rrjet të parregullt me profil kryesisht joadekuat të komunikacionit për lagjen Medrese-Çamëria. Rrjeti ekzistues rrugor është i përbërë kryesisht nga rrugë të asfaltuara, të shtruara me kalldrëm dhe kubëza betoni por gjithashtu ka edhe rrugë të pashtuara. Në bazë të shtrirjes së rrjetit rrugor, shihet se është bërë një zhvillim i çrregullt i rrjetit pa ndonjë zgjidhje urbane dhe pa kriter të përcaktuara paraprakisht.

Rrjeti rrugor ekzistues është i përbërë nga rrugë me karakteristika gjeometrike të ndryshme si dhe udhëkryqe të kategorive dhe formave të ndryshme.

Infrastruktura teknike – rrjetet ekzistuese të ujësjellësit, kanalizimit, dhe energjisë elektrike janë në gjendje jo të mirë, infrastrukturë e vjetëruar, me kapacitet jo të mjaftueshëm.



### 3.2.2 Pamje nga lagjeja

Sekuenca nga profili urban, qershor - nëntor 2009:




Figura 2 Terreni i lagjes, profili i hekurudhës

Shenime më të hollësishme për gjenjden ekzistuese jepen në Profilin Urban të hartuar për lagjen në fjalë në periudhën qershor – nëntor 2009.



Figura 3 Pamje nga terreni, hulumtimi i profilit urban





### 3.2.3 Përparësitë dhe Mangësitë e lagjes në gjendjen ekzistuese

Elementet cilësore që mund të konsiderohen si PËRPARËSI të lagjes janë:

- Pozita e saj në raport me qytetin dhe zonën e vjetër të qytetit;
- Pozita e saj në raport me Unazën;
- Gjelbërimi ekzistues;
- Hapësira e lirë e pandërtuar;
- Konfiguracioni i terrenit;
- Shkollat ekzistuese;
- Lumi ekzistues Prishtevka, etj.

Elementet kritike që përcaktohen si MANGËSI janë:

- Mungesa e infrastrukturës:
  - rrugët e paasfaltuara, të ngushta,
  - rrjeti elektrik i mbingarkuar,
  - mungon ngrohja qendrore,
  - mungon rrjeti i kanalizimit,
  - presioni i pamjaftueshem i ujit.
- Parcelat e vogla dhe objektet e ndërtuara në mënyrë të çrregullt
- Mungesa e përmbajtjeve të mjaftueshme shoqërore;
- Mungesa e parkingjeve publike dhe private; etj.

*Vërejtje:*

*Gjendja ekzistuese është trajtuar në hollësi në fazën e parë – hartimit i Profilit Urban. Për këtë shih dokumentin Profili Urban.*



### 3.3 DESTINIMI I SIPËRFAQEVE

#### 3.3.1 Plani Strategjik 2004-2020

Në vitin 2004 është miratuar Plani Strategjik Zhvillimor Urban i Prishtinës nga ana e Kuvendit Komunal. Bazuar në këtë plan lagja "Medrese-Çamëri" shtrihet në dy zona të ndryshme; pjesa perëndimore dhe jugore kategorizohet si Zonë Mikse Urbane dhe pjesa tjetër e lagjes është paraparë Zonë kryesisht Banimi.






Figura 4 Plani Strategjik Zhvillimor Urban i Prishtinës

Në fig.4 shihet se në lagjen "Medrese-Çamëri" është e lejuar të ndërtohen objektet me etazhitet deri P+3, gjegjësisht deri në P+5 por gjithmonë duke respektuar edhe parametrat tjerë të dendësisë urbane.

Tab.2 Dendësia urbane dhe numri i kateve sipas PSZhUP

|   | Number of<br>total stories | SUI<br>(residential and industrial) |     | FSI     |
|---|----------------------------|-------------------------------------|-----|---------|
|  | I-IV                       | 0,2-0,3                             | 0,6 | max 0,8 |
|  | II-VI                      | 0,3-0,4                             | 0,8 | max 1,2 |

#### Vërejtje:

Për shkak të gjenjdes kaotike sidomos në pjesën jugore dhe qendrore të lagjes, nevojës për zgjerimin e rrugëve ekzistuese dhe hapje të koridoreve të reja është dhënë propozim nga Bordi i drejtorëve të Kuvendit Komunal të mbajtur me dt.28/06/2011 që të rritet koeficienti total i ndërtimit në raport me Planin Strategjik.

Pas shqyrtimit publik të planit dhe konslutimit me Drejtorinë e Urbanizmit është konkluduar që të ruhen koeficientat nga plani strategjik siç vijon:  
 ISD = 0.8 -1.2 ndersa shputa ISHP=0.3-0.4.

Në takimin e fundit me Bordin e Drejtorëve me dt. 15.12.2011 është vendosur që në tërësinë A ISD-ja të rritet nga 1.2 në 2.0 dhe në tërësinë B nga 0.8 të bëhet 0.9.

Për shkak të afatit të shkurtër deri në dalje në Kuvend me dt.29.12.2011 ka mbetur obligim i kompanisë që edhe pas miratimit në Kuvend të bëjë plotësimet e blloqeve Urbane.



### 3.3.2 Destinimi i sipërfaqeve

Sipërfaqja e lagjes Medrese Çamëri destinohet për qëllime të ndryshme konform nevojave të lagjes në radhë të parë, dhe normave dhe standardeve për planifikim të lagjes së tillë. Destinimi apo shfrytëzimi i tokës në lagjen Medrese-Çamëri ndahet në këto kategori:

- I. SIPËRFAQJA E NDËRTUAR
- II. SIPËRFAQJA E GJELBËRT
- III. SIPËRFAQJA E TRANSPORTIT
- IV. SIPËRFAQJA SPECIFIKE

Këto sipërfaqe janë të gërshetuara dhe të strukturuar në tërësi (zona) dhe blloqe urbanistike.

#### I. SIPËRFAQJA E NDËRTUAR

Sipërfaqja e ndërtuar përbëhet nga ndërtesat për:

1. Banim;
2. Institucione dhe përmbajtje tjera publike; si dhe
3. Afarizëm (ndërmarrjet tregtare, zejtare, shërbyese dhe hotelierike)

Rrugët për qasje brenda këtyre funksioneve mund të llogariten pjesë e sipërfaqes së ndërtuar nëse i përgjigjen karakterit të përgjithshëm të zonës.

Sipërfaqja e ndërtuar në PRRU Medrese-Çamëria përfshinë një sipërfaqe prej 26.8 ha.

#### II. SIPËRFAQJA E GJELBËRT DHE E LIRË

Në sipërfaqet e gjelbra bëjnë pjesë:

1. Sport dhe rekreacion – fushat për këtë qëllim, përfshirë objektet përcjellëse.
2. Shesh – hapësirë e lirë publike
3. Park / Hapësirë e gjelbër
4. Shirit gjelbërimi – përfshirë brezat me gjelbrim të lartë
5. Sipërfaqe ujore - lumenjtë, liqenet, pellgjet dhe sipërfaqe tjera ujore.

Sipërfaqet e lira janë të gjitha zonat dhe ngastrat që nuk janë të definuara si sipërfaqe ndërtimore, sipërfaqe specifike apo sipërfaqe e transportit.

Sipërfaqe të pa ndërtuar apo të gjelbërt 42.32 ha.

#### III. SIPËRFAQJA E TRANSPORTIT

Sipërfaqet e transportit përbëhet nga korridori i transporti ku hyjnë:

1. Rugët - sipërfaqe të dedikuara për qarkullim të automjeteve;
2. Shtigjet për këmbësor dhe çiklist - janë sipërfaqe që përcjellin rrugën publike të dedikuara për qarkullim të këmbësorëve dhe çiklistëve;

Sipërfaqja e transportit në PRRU Medrese-Çamëria përfshinë një sipërfaqe prej 17.37 ha.

#### IV. SIPËRFAQJA SPECIFIKE

Sipërfaqet specifike përbëhen nga zonat të cilat janë të dedikuara vetëm për ndërtesat dhe sipërfaqet specifike në vijim:

- a. Zonat e të cilat nuk mund të jenë pjesë përbërëse të tokës ndërtimore, sipërfaqeve të gjelbra apo sipërfaqeve të transportit në bazë të tipologjisë dhe shfrytëzimit të tyre dhe rrethanave.



### 3.3.3 Ndarja e tërësive dhe blloqeve urbane

Për funksionim më efikas, menaxhim, zhvillim, orientim dhe rregullim më të lehtë të lagjes është e domosdoshme ndarja e saj në tërësi (zona) dhe blloqe urbane. Blloku është njësia më e vogël urbanistike dhe kufizohet me rrugë lokale që sipas standardeve duhet të kenë distanca prej 75-180m në blloqet e banimit.

Në lagjen "Medrese-Çamëri" diferencojmë 3 tërësi (zona) të ndryshme që kanë parametrat e veçantë:

1. Zonë mikse(ZM) –tërësia A
2. Zonë banimi(ZB) – tërësia B
3. Zonë e shërbimeve Publike(ZP)– tërësia C

#### 1. ZONA MIKSE-(ZM) - tërësia A

Definohet si zonë e Përzier banimi rezidencial në kombinim me shërbime komerciale joshqetësuese në përdhësë. Pjesaveriperendimore (VP)e lagjes është pjesa më e lirë e lagjes që ka mundësi planifikimi të mirëfillt sipas normativave dhe standardeve dhe planifikohet pothuajse nga e para ndërsa pjesa jugore (J) kanjëgjendje ekzistuese kaotike ku ka shumë banorë dhe shtëpitë janë shumë të koncentruara pothuajse të ngjitura me njëra tjetrën. Është propozuar që të mundësohet riorganizimi i tyre me rritjen e koeficientave dhe planifikimin e rrugëve të reja. Kjo realizohet me bashkimin e pronareve në nënblloqe te vogla urbane dhe me ndërtim të ri sipas parametrave të dhëna me këtë plan.

Zona mikse (ZM) ka 32 blloqe urbane (A1-A32) me sipërfaqe të përgjithshme prej 45.16 ha.




Figura 5 Tërësia A - Zona mikse



Zona mikse përmbanë:

1. Banim – 75% e sipërfaqes së ndërtuar
  - a. objekte të banimit shumëbanesor
  - b. objekte përcjellëse për nevojat e banimit, si p.sh. garazhe
  
2. Afarizëm – 25% e sipërfaqes së ndërtuar
  - a. Afarizëm në përdhësë të objekte shumëbanesore
  - b. Objekte të veqanta afarizmi

*Kushtet: Afarizmi në zonë mikse nuk guxon të*

  - *shkaktojë dëme në rrethinë dhe mjedis*
  - *paraqet rrezik (zjarri, eksplozimi, ndotje etj.) për banorët*
  - *shkaktojë zhurmë më shumë se 45 db – natën dhe 55 db – ditën*
  - *ndikojnë negativisht në cilësinë e banimit, jetës dhe karakterit të bllokut.*

*Funksionet e lejuara janë: Ndërmarrje tregtare, Ndërmarrje zejtare, Ndërmarrje shërbyese, Ndërmarrje – organizata private arsimore / shëndetësore / kulturore etj. që nuk çënojnë kushtet e sipërsënuara dhe posedojnë licencë për veprimtari përkatëse.*
  
3. Përmbajtje publike
  - a. Fushëlojë për fëmijë
  - b. Parking
  - c. Këndi për mbeturina / shporta bërllogu
  - d. Park /Këndi për pushim - me gjelbrim të ulët dhe të lartë.

*Kushtet: secili bllok apo nënblok duhet të ketë përmbajtjet e sipërsënuara publike konform kapaciteteve të bllokut, respektivisht numrit të banorëve dhe standardeve ndërkombëtare.*

*Posta, shërbimet komunale duhet të ofrohen konform politikave dhe obligimeve shtetërore.*
  
4. Përmbajtje tjera që nuk bien ndesh me funksionin primar të banimit dhe nuk çënojnë interesat e banorëve.

## 2. ZONË BANIMI - ZB (tërësia B)

Pjesa verilindore (VL) ka situatë të ngjashme urbane por me koeficinta më të ulët të ndërtimit. Pjesa VL është relativisht e lirë dhe mundësohet organizimi i saj sipas parametrave të këtij plani. Definohet si zonë banimi individual.

Zona e banimit ZB përmbanë 13 blloqe urbane (B1-B13) me sipërfaqe të përgjithshme prej 11.79ha.




Figura 6 Tërësia B - zona e banimit

Zona e banimit (ZB) përmbanë:

5. Banim – 80% e sipërfaqes së ndërtuar
  - a. objekte të banimit individual
  - b. objekte përcjellëse për nevojat e banimit, si p.sh. garazhe
  
6. Afarizëm – 20% e sipërfaqes së ndërtuar
  - a. Afarizëm në përdhese të objekteve të banimit individual

*Kushtet: Afarizmi në zonëbanimi nuk guxon të*

  - *shkaktojë dëme në rrethinë dhe mjedis*
  - *paraqet rrezik (zjarri, eksplodimi, ndotje etj.) për banorët*
  - *shkaktojë zhurmë më shumë se 45 db – natën dhe 55 db –ditën*
  - *ndikojnë negativisht në cilësinë e banimit, jetës dhe karakterit të bllokut.*

*Funksionet e lejuara janë: Ndërmarrje tregtare, Ndërmarrje zejtare, Ndërmarrje shërbyese, Ndërmarrje – organizata private arsimore / shëndetësore / kulturore etj. që nuk çënojnë kushtet e sipërshtënuara dhe posedojnë licencë për veprimtari përkatëse.*
  
7. Hapësirë e lirë / Përmbajtje publike
  - Gjelbrim i ulët dhe i lartë.

*Hapësirat e lira janë përgjegjësi e pronarit (banorit) dhe realizohen brenda parcelës private.*
  
8. Përmbajtje tjera që nuk bien ndesh me funksionin primar të banimit dhe nuk çënojnë interesat e banorëve.



### 3. ZONA PËR SHËRBIME PUBLIKE - ZP:(tërësia C)

Zona për shërbime publike ZP përmbanë 20 blloqe urbane (C1-C20) me sipërfaqe të përgjithshme prej 23.56 ha.

Në këtë zonë përfshihen objektet për shërbime publike ekzistuese dhe të propozuara:



Figura 7 Tërësia C - zona publike

#### Ekzistuese:

- Shkolla fillore dhe ajo e mesme e ulët "Gjelbërt";
- shkolla fillore dhe e mesme e ulët;
- xhamia,
- Qendra e Mjeksisë Familjare,
- shkolla e mesme fetare "Alaudini"
- Terreni sportiv KF Flamurtari.

#### Të propozuara:

- hapësira për sport, rekreim për të rinjë (C8),
- qendra e lagjes (C9, C10),
- qendra multifunksionale (C11)
- objektet parashkollore (C4, C6, C11),
- pjesë të gjelbëruara,



Në blloqet C9 dhe C10 mund të organizohet qendra e lagjes me përmbajtje të ndryshme publike, shërbime komunale, postë, qendër komuniteti, qëndër rinore etj., varësisht prej nevojave të banorëve dhe komunës dhe mundësive për investim.


Tab.3 Koeficientat e ndërtimit

| teresia              | tipi i shfrytëzimit             | Sip. (Ha) | Perqindja % | ISHP | ISD | Sip. Ndert perdhese (m <sup>2</sup> ) | Sip. Totale ndertimi (m <sup>2</sup> ) | Sip. Gjelberimi (Ha) | nr. ban. | nr. ban/ha. |
|----------------------|---------------------------------|-----------|-------------|------|-----|---------------------------------------|--|----------------------|----------|-------------|
| A                    | Zone Mikse (ZM)                 | 45.16     | 46.14%      | 0.4  | 2.0 | 180,656                               | 903,280                                | 18.07                | 28,792   | 638         |
| B                    | zone Banimi (ZB)                | 11.79     | 12.05%      | 0.4  | 0.9 | 47,170                                | 106,132                                | 5.90                 | 1,685    | 143         |
| Siperfaqe Banimi:    |                                 | 56.96     | 58.18%      |      |     | 227,826                               | 1,009,412                              | 23.96                | 30,477   | -           |
| C                    | Zone e shpërbimeve publike (ZP) | 23.56     | 24.07%      | /    | /   | 31,518                                | 84,154                                 | 18.36                | 0        | -           |
| Siperfaqe e rrugëve: |                                 | 17.38     | 17.75%      |      |     |                                       |  |                      |          |             |
| totali:              |                                 | 97.89     | 100.00%     |      |     | 259,343                               | 1,093,565                              | 42.33                | 30,477   | 260         |



Figura 8 Destinimi i sipërfaqeve dhe tërësisë





### 3.4 VIJAT RREGULLATIVE TË RRUGËVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE SI DHE VIJAT NDËRTIMORE

Planifikimi i ngastrave dhe ndërtesave individuale në lagje varet nga lokacioni dhe kushtet e përgjithshme të rregullimit.

Kushtet për planifikimin e lokacionit / ngastrës janë:

- vija rregullative
- vija ndërtimore
- raporti sipërfaqja e shputës/ sipërfaqja e lirë
- lartësia dhe etazhiteti i ndërtesës (indeksi i ndërtueshmërisë)
- raporti në mes të ndërtesave
- forma dhe madhësia e ngastrës
- mundësia e organizimi të ndërtesës në ngastër
- qasja në ngastër
- hapësira e parkimit
- hapësira e gjelbërimit
- riparcelimi

Këto karakteristika ndryshojnë varësisht prej llojit të veprimtarisë.

**Vija rregullative** ndanërrugën e propozuar publike me vijën frontale të ngastrës. Ngastrat të cilat kanë qasje në rrugën publike janë të obliguar që ta ndryshojnë vijën e ngastrës e me këtë përcaktohet edhe vija rregullative e tyre.

- Vija rregullative është definuar me vijë të ndërprerë me ngjyrë të zezë.

#### **Vija ndërtimore**


Distanca e përcaktimit të vijës ndërtimore nga vija rregullative është:

- min. 7.0 m (rrugë Kategoria I)
- min. 6.0 m (rrugë Kategoria II)
- min. 5.0 m (rrugë Kategoria III, IV dhe V)

Kushti themelor që ka përcaktuar distancën mes vijës së rregullimit dhe asaj të ndërtimit është distanca mes ndërtesave / mundësimi i insulimi adekuat.

Në ngastrat publike të veçanta vija ndërtimore mund të jetë edhe më e thellë p.sh. institucionet parashkollore, salla polivalente, kompleksi i shkollave, etj.

- Thellësia e preferuar e ndërtesës pas vijës ndërtimore është max. 15 m;
- Ndërtimi është i lejuar vetëm pas vijës ndërtimore. Tejkalimi i elementeve të ndërtesës si strehat, ballkonet, etj, mbi katin përdhësë mund të shkojnë deri në 1.4 metra;
- Vija ndërtimore në pjesën grafike është definuar me vijë të ndërprerë me ngjyrë të kuqe.



### 3.5 PIKAT E LARTËSISË SË RRUGËVE DHE SIPËRFAQEVE PUBLIKE (PLANI I NIVELIMIT)

Plani i nivelimit përcakton lartësitë niveluese të rrugëve dhe sipërfaqeve publike të planifikuara në raport me nivelimin ekzistues të terrenit dhe rrugëve ekzistuese. Lartësitë e dhëna të nivelit të rrugëve të planifikuara kanë karakter orientues dhe janë të mundshme përmirësimet në zgjidhjen teknike gjatë realizimit të rrugëve në terren.

### 3.6 ZGJIDHJA E RRJETIT TË INFRASTRUKTURËS: RRUGËVE, FURNIZIMIT ME UJË, UJËRAVE TË ZEZA, UJËRAVE ATMOSFERIKE, TELEKOMUNIKIMET, ELEKTRICITETIT, ETJ. DHE KYÇJET NË INFRASTRUKTURË

#### 3.6.1 Rrjeti rrugor - transporti

Lagja Medrese-Çamëri ndodhet në një distance jo të largët nga zona qendër e qytetit. Përgjatë saj shtrihen arterie që lidhin zona rurale në periferi të qytetit si dhe traseja e hekurudhës.

##### 3.6.1.1 Zgjidhja e udhëkryqeve problematike

Dy nga udhëkryqet më problematike janë analizuar në versione të ndryshme dhe janë propozuar për rregullim si në vijim:

#### KRYQËZIMII RRUGËVE RRUGA E LLAPIT –BAJRAM BAHTIRI




Figura 9 Udhëkryqi Rruga e Llapit – Rruga Bajram Bahtiri

Hapësira në dispozicion dhe objektet e shumta në afërsi të udhëkryqit kushtëzojnë edhe zgjidhjen e rrugullimit të qarkullimit në hyrje të udhëkryqit. Janë analizuar mundësitë e aplikimit të:

- Opsioni 1 - Rrethrotullimi me dy korsi urbane
- Opsioni 2 - „Mini rrethrotullimi“
- Opsioni 3 - Udhëkryq me përparësi kalimi
- Opsioni 4 - Udhëkryq me sinjalizimi ndricues-semafor



Bazuar nga të dhënat për udhëkryqin e trajtuar, numri i automjeteve në degët hyrëse arrin rreth 500 aut/h, e ky numër i automjeteve do të rritet edhe më tej me karakterin dhe rëndësinë e rrugëve që do të marrin në të ardhmen. Nga ana tjetër, prania e këmbësorëve është gjithashtu e madhe për shkak të aktiviteteve të shumta në këtë pjesë.




Figura 10 Opsioni 1 dhe 2

Prandaj është vendosur për aplikim të zgjidhjes me ndriqim sinjalizues – semafor. Vendosja e semaforëve do të ketë përparësitë por edhe mangësitë, megjithatë është zgjidhja më e mirë nga 3 opsionet tjera.

Pra, në pjesën e rrugës ku kyqet rruga dytësore në rrugën kryesore të bëhet rregullimi me prioritet, ndërsa në kryqëzimin e rrugëve “Llapi” me rrugën “ Bajram Bahtiri” rregullimi i qarkullimit të bëhet me semafor.

Veprimet shtesë, të cilat duhet të merren për qëllim të ngritjes së nivelit të shërbimit dhe sigurisë janë:

- Vendosja e sinjalizimit shtesë me paralajmërim përgjatë rrugës me prioritet,
- Paralajmërimi i sinjaleve ndriçuese për mes shenjës vertikale,
- Shtimi numrit të shiritave me qëllim të zvogëlimit të numrit të automjeteve për shirit,
- Ndryshimi i përmasave gjeometrike në kuptim të orientimit më të drejtë të qarkullimit dhe fitimit në kohë për kalim të automjeteve dhe në të njëjtën kohë mundëson kalim më të lehtë të këmbësorëve,
- Ndalimi i ndërrimit të shiritit afër udhëkryqit,
- Zbatimi i masave tjera në varshmëri të llojit të terrenit.



Figura 11 Zgjidhja e aprovuar.

#### KRYQËZIMI I RRUGËVE HAXHI ZEKA – ABEDIN REKA





Figura 12 Udhëkryqi dhe zgjidhja e propozuar

Përshkak të konfiguracionit të terrenit-disnivel i madh dhe objekteve të banimit, mundësitë për një zgjidhje më të mirë janë të kufizuara. Janë analizuar dy opsione:

- Opsioni 1- Mbushje dhe gjërmim me qëllim të arritjes së pjesërtësisë së pranueshme
- Opsioni 2- Eliminimi i tërësishëm i kyçjes në rrugën kryesore

Aprovohet opsioni 2 – eliminimi i tërësishëm i kyçjes, duke pasur parasysh vështirësitë e kyçjes në kyçjen ekzistuese dhe pamundësisë për korigjimin e saj.



### 3.6.1.2 Kategorizimi i rrugëve të propozuara

Me qëllim të lidhjes funksionale të rrjetit rrugor dhe me qëllim të përmbushjes së kriteve bazë të elementeve gjeometrike të rrugëve dhe të qarkullimit në përgjithësi, kategorizimi i rrugëve është bërë si në vijim:

- I. Rrugë Kategoria I ( gjerësia 20m),
- II. Rrugë Kategoria II ( gjerësia 10.5m),
- III. Rrugë Kategoria III ( gjerësia 9m),
- IV. Rrugë Kategoria IV ( gjerësia 8.5 m)
- V. Rrugë Kategoria V ( gjerësia 7.5m)



### Rrugët Kategoria I

Rrugë e kapacitetit më të lartë në kuadër të rrugëve urbane, të cilat tregojnë një ngarkesë trafiku të mesme-të lartë, të cilat kanë funksionet e mëposhtme: lidhin zonën me zonat tjera për rreth, qendrën e qytetit dhe rrugët tjera me hyrje për në qendër, kalojnë në pjesë më të rëndësishme të zonës, lidhin direkt njësitë e ndryshme të zonës me qëllim që rrjeti në tërësi të jetë sa më efikas.

Profili: trotuar /gjelbrim /shirit 2 korsi /gjelbrim /shirit 2 korsi /shteg biçikletësh /trotuar




Figura 13 Profili i rrugës kategoria I



## Rrugët Kategoria II

Rrugë urbane me kapacitet të mesëm, me funksionet e mëposhtme:  
mbledhjen/shpërndarjen e trafikut ndërmjet rrugëve primare dhe linjat me kapacitet të ulët të rrjetit, nën -lidhjet me rrugët tjera në kuadër të lagjes

Profili: trotuar me gjelbrim /shirit 2 korsi /trotuar me gjelbrim




Figura 14 Profili i rrugës kategoria II



### Drugët Kategoria III

Drugët urbane me kapacitet më të ulët për një zonë të caktuar.

Profili: trotuar /shirit 2 korsi /trotuar




Figura 15 Profili i rrugës kategoria III





### Drugët Kategoria IV dhe IV'

Drugët urbane me kapacitet të ulët me hyrje lokale për një zonë të caktuar.

Profili: trotuar /shirit 2 korsi /trotuar




Figura 16 Profili i rrugës kategoria IV




Figura 17 Profili i rrugës Kategoria IV' (përgjatë shkollës)



### Drugët Kategoria V

Janë rrugët e nivelit më të ulët në lagje që shërbejnë për shpërndarje në bllokun e brendshëm.

Profili: trotuar /shirit 2 korsi /trotuar




Figura 18 Profili i rrugës kategoria V



Profili L (i lumit):

Rruga (trotuar /shirit 2 korsi /trotuar) / gjelbrim / gjelbrim / shetitore / lumi / gjelbrim /shetitore / gjelbrim




Figura 19 Profili i lumit



Profili H (i hekurudhes):  
hekurudha / muri mbrojtës kundër zhurmës / gjelbrim i lartë




Figura 20 Profili i hekurudhës



### 3.6.1.3 Transporti Publik

Kjo lagje përshkohet me linja të transportit publik përgjatë rrugës që lidhet me zonat rurale në periferi të qytetit. Ndërsa, me zona tjera të rëndësishme të qytetit lidhet përmes kombibusëve që qarkullojnë në linjat 7 dhe 7A dhe 3A. Pjesa më e madhe e zonës lëvizjet i realizon duke u shërbyer me automjete personale, lëvizjen në këmbë dhe shërbimin Taxi.

Linja Nr.7: Kolovica e vjetër-Ndërmarrja e tekstilit "Kosova -Tex"


Në ardhje: Nga Kolovica e Vjetër Rr."Haxhi Zeka", vazhdon rr."Ibrahim Lutfiu", majtas në Rr. "Agim Ramadani", djathtas në Rr. "Eqrem Çabej", Rr. "Bill Clinton", Rr. "Lidhja e Pejës", majtas në Rr. "Tahir Zajmi" dhe përfundon në platonë para Kosovatex-it.

Vendndaljet: Për këtë linjë janë gjithsej 14 vendndalje të autobusëve për njërin drejtim dhe 14 në drejtimin tjetër, të cilat bazuar në distancën e linjës, janë të mjaftueshme për përmbushjen e kriterëve të transportit urban

Linja Nr.7A: Lagjja e Vreshtave-N. e tekstilit "Kosova-Tex".

Në ardhje: Nga lagjja "Vreshtat" - Lesna, Rr. "Haxhi Zeka", djathtas në Rr. "Lidhja e Prizrenit", majtas në Rr. "Ilir Konushevci", vazhdon në Rr. "Agim Ramadani", djathtas në Rr. "Fehmi Lladroci", majtas në rr."Muharrem Fejza" (ose shkon deri te rrethi dhe prap kthehet në rr."Muharrem Fejza) dhe përfundon te Arkiva e Kosovës.

Gjithashtu edhe për linjën Nr.7A.-janë 14 vendndalje të autobusëve për njërin drejtim, ndërsa në drejtimin tjetër 13,, të cilat bazuar në distancën e linjës, janë të mjaftueshme për përmbushjen e kriterëve të transportit urban



Linjat e transportit urban për qytetin e Prishtinës





Figura 21 Rrjeti i trafikut urban




#### 3.6.1.4 Qarkullimet e këmbësorëve

Karakteristikat primare të qarkullimeve të këmbësorëve në pjesën e rrugës për këmbësorë, për nga natyra janë të ngjashme me karakteristikat e qarkullimit të automjeteve në pjesën e rrugës. Sikurse të qarkullimi i automjeteve, ekzistojnë indikatorë të shumtë të shkallës së mobilitetit për qarkullim të këmbësorëve në rrugët për këmbësorë. Që të kompletohet kjo analizë e relacioneve themelore ndërmjet qarkullimit të këmbësorëve dhe hapësirës përkatëse në dispozicion për këmbësorë, duhet të analizohet gjerësia efektive e rrugës për këmbësorë.

Prandaj, hapësira përkatëse në dispozicion për këmbësorë, sidomos në rrugët sekondare dhe ato terciare, janë të gjerësisë së pamjaftueshme në raport me fluksin e këmbësorëve. Duke analizuar, destinimin e zonës dhe atraktivitetin e saj, rrjedh se një numër i madh i lëvizjeve realizohen në këmbë.

Nga literatura profesionale distanca e lëvizjes deri në 150 metra, përmban 100% lëvizje të këmbësorëve në strukturën e përgjithshme të qarkullimit. Prandaj, aktivitetet e këmbësorëve realizohen kryesisht në distanca të vogla, gjë që edhe e rritë lëvizjen e tyre ndërmjet zonave.





## 3.6.2 Rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit

### 3.6.2.1 Gjendja egzistuese

Infrastruktura e ujit dhe e kanalizimit në lagjet Medrese-Çamëria nuk dallon shumë nga gjendja në lagjet tjera të Prishtinës ku dominon një infrastrukturë relativisht e vjetër dhe e ndërtuar për një numër të kufizuar banorësh dhe biznesesh. Me sistemin e menagjimit dhe operimeve të sistemit të furnizimit me ujë të pijes dhe largimit të ujërave të ndotura përgjegjëse është Kompanija Rajonale e Ujësjellesit "Prishtina".

Rrjeti i ujit - është kryesisht i tipit të degëzuar dhe dominon nga gypat e Azbest-Qimentos dhe një pjesë e vogël nga materiali PVC. Diametrat sillen nga D-150 mm deri në D-63 mm. Lagja ka dy furnizime ujë nga i njëjti burim. Furnizimi me ujë në këtë lagje bëhet nga Liqeni i Batllaves përmes rezervuarve egzistues në Kodren e Trimave 1 dhe Kodren e Trimave 2 përmes Stacionit të pompave. Rezervuarët gjenden në kotat 650m n.d. dhe 710m n.d. Lagjen e përshkon gypi transportues nga qeliku me D-500 mm nga rezervuari Kodra 2 deri në rezervuarin e Vreshtave që njëkohësisht furnizon rreth 1/3 e lagjes Medrese-Qamëria.

Rrjeti i kanalizimit - Rrjeti i kanalizimit si ai sanitar dhe ai atmosferik kanë një orientim të natyrshëm në drejtim të lumit Prishtina gjegjësisht Kolektorëve kryesorë që shërbejnë për largimin e ujërave të shiut. Rrjeti i kanalizimit fekal është i ndërtuar kryesisht nga materiali i Betonit dhe i Azbest-Qimentos me diametra prej D-150 mm deri në D-300 mm. Përgjat Kolektorit të lumit Prishtevka është i vendosur gypi largues i ujërave fekal me D-500 mm që shërben për grumbullimin e ujërave nga kjo lagje dhe lagjet tjera periferike që vijnë nga Kodra e Trimave, Lagja Kolevica e Lagja e Vreshtave.

|   | Shtigje, etj                        | 0.10                             |        |  |
|   | Komerciale - publike                | 100%                             |        |  |
|   | Banim                               | 0%                               |        |  |
|   | nr.i garazheve/parkingjeve          | 0                                |        |  |
|   | Vija e Ndertimit                    | (m <sup>2</sup> )                | 0      |  |
|   | Building line / gradjevinska linija |                                  |        |  |
|   | Sipërfaqe ne Përdhesë               | (m <sup>2</sup> )                | 0      |  |
|   | Basement Area / Površina prizemlja  |                                  |        |  |
|   | Sipërfaqe totale e ndërtimit        | (m <sup>2</sup> )                | 0      |  |
|   | Build Area / Gradjevinska površina  |                                  |        |  |
|   | Sipërfaqe Gjelbërimi                | (m <sup>2</sup> )                | 30,613 |  |
|   | Green Area / Zelena površina        |                                  |        |  |
|   | Sipërfaqe Publike                   | [m <sup>2</sup> ]                | 0      |  |
|   | Public Area / Javni Prostor         |                                  |        |  |
| Sipërfaqe Banimi  | [m <sup>2</sup> ]                   | 0                                |        |  |
| Residential Area / stambena površina                      |                                     |                                  |        |  |
| Sipërfaqe e Bodrumit                                      | [m <sup>2</sup> ]                   | 0                                |        |  |
| Underground Area / Površina Podzemlja                     |                                     |                                  |        |  |
| Numri i banorëve  |                                     |                                  | 0      |  |
| No. inhabitants / br. Stanovnika                          |                                     |                                  |        |  |
| Banor/ha  |                                     |                                  | 0      |  |
| Inhab/ha / stan/ha  |                                     |                                  |        |  |
| Numri i fëmijëve  |                                     |                                  | 0      |  |
| no. children / br. Dece                                   |                                     |                                  |        |  |
| Numri i njësjive të banimit                               |                                     |                                  | 0      |  |
| no. residential units / broj stambenih jedinica           |                                     |                                  |        |  |
| Kategoritë e rrugëve                                      |                                     |                                  | H      |  |
| Road Types / Kategorije puteva                            |                                     |                                  |        |  |

**NR. NGA STRAVE KADASTRALE / NR. PLOTS / BR. PARCLE :**

- 1040-0
- 1041-0
- 1042-0
- 1043-1
- 1043-2
- 1043-3
- 1044-0
- 1953



**VËREJTJE / COMMENT / NAPOMENA :**


Me miratimin e planit për çdo bllok duhet të hartohet plani detaj ku do të përfshihen të gjithë parametret e infrastrukturës brenda parcelave urbane të banimit ku mund të ketë inkomporime, ndërsa rrugët kryesore nuk do të pësojnë ndryshime. Planet detaje duhet të përmbajnë hapësirat e gjelbërta dhe të rekreacionit, parkingjet, rrugët e brendshme, trotualet, hapësirat për infrastrukturë (furnizimi me ujë, kanalizimi, ngrohja, rryma, telefonia, etj.)

/ With the approval of the plan for each block must be draft detail plan where will be included all parameters of infrastructure inside living urban parcels, where some incorporations can be added but the main roads won't have changes. Detail plans should contain green and recreation areas, parking places, internal roads, sidewalks, areas for infrastructure (water supply and sewerage, heating, electrical power, telephone, etc).

/ Sa prihvacenjem plana za svaki blok treba da se uradi detaljni plan gde ce da se obuhvataju svi parametri infrastrukture unutar stanbenih urbanih parcela, gde moze imati inkomporiranje, ali glavnih putevi nece imati promene. Detaljni planovi moraju imati zelene i rekreativne prostore, parking, unutrashnje puteve, trotoare, prostor za infrastrukturu snabdevanje vodom, kanalizacijom, grejanjem, elektricnom energijom, telekomunikacijom, itd.)

**LEGJENDA / LEGEND / LEGENDA**

- kufiri i zonës së PRU "Medrese - Çamëri"  
/boundary of URP / granica URP "Medrese - Çamëri"
- vija e rregullimit  
/regulation line / regulaciona linija
- vija e ndërtimit  
/building line / gradjevinska linija
- objektet ekzistuese  
/existing buildings / postojeći objekti
- hekurudha  
railway / željeznica
- parcelimi kadastral  
/cadastral plots / katastarska parcelacija
- riparcelimi i propozuar  
/proposed new plots / riparcelacija
- prona publike  
/public property / javna imovina
- Objekt ekzistues shendetesor (QMF)  
/existing health facility / postojeća zdravstvena ustanova
- Objekt ekzistues banimi (social)  
/ex. social residential ob. / postojeći socijalni stambeni stanovi
- objekt ekzistues shkollor  
/existing school facility / postojeća školska ustanova
- objekt ekzistues fetar (xhami)  
/existing religious facility / postojeći vjerski objekt (dzamija)
- institucion i propozuar parashkollor  
/proposed preschool institution / predložena predškolska ustanova
- Terrene sportive  
/sport terrains / sportski tereni
- Qender multifunksionale  
/multifunctional center / višenamenski centar
- hapësire publike  
/public space / javni prostor



printuar: tetor 2012

| ID   | Blloku                              |                                  |
|--|-------------------------------------|----------------------------------|
|  |                                     | Bloc/ blok                       |
|  | Destinimi                           | Z.P. brezi i gjelb. i hekurudhes |
|  | /Uses / namena                      | P.Z. green area / P.Z. zelenilo  |
|  | Sipërfaqja e bllokut                | [m2] <b>2,830</b>                |
|  | Bloc Area / površina bloka          |                                  |
| TREGUESIT NDËRTIMOR<br>/BUILDING CODES/GRADJ. POKAZATELI | Etazhiteti (Lartësia max.)          | <b>0</b>                         |
|  | Stories / Etazitet                  |                                  |
|  | ISHP                                | <b>0.00</b>                      |
|  | ISD                                 | <b>0.00</b>                      |
|  | ISHB                                | <b>0.00</b>                      |
|  | ISG                                 | <b>1.00</b>                      |
|  | Shtigje, etj                        | <b>0.10</b>                      |
|  | Komerciale - publike                | <b>100%</b>                      |
|  | Banim                               | <b>0%</b>                        |
|  | nr.i garazheve/parkingjeve          | <b>0</b>                         |
|  | Vija e Ndertimit                    | (m²) <b>0</b>                    |
|  | Building line / gradjevinska linija |                                  |
|  | Sipërfaqe ne Përdhesë               | (m²) <b>0</b>                    |
|  | Basement Area / Površina prizemlja  |                                  |
|  | Sipërfaqe totale e ndërtimit        | (m²) <b>0</b>                    |
|  | Build Area / Gradjevinska površina  |                                  |
|  | Sipërfaqe Gjelbërimit               | (m²) <b>2,830</b>                |
|  | Green Area / Zelena površina        |                                  |
|  | Sipërfaqe Publike                   | [m2] <b>0</b>                    |
|  | Public Area / Javni Prostor         |                                  |
| Sipërfaqe Banimi   | [m2] <b>0</b>                       |                                  |
| Residential Area / stambena površina                     |                                     |                                  |
| Sipërfaqe e Bodrumit                                     | [m2] <b>0</b>                       |                                  |
| Underground Area / Površina Podzemlja                    |                                     |                                  |
| Numri i banorëve   | <b>0</b>                            |                                  |
| No. inhabitants / br. Stanovnika                         |                                     |                                  |
| Banor/ha   | <b>0</b>                            |                                  |
| Inhab/ha / stan/ha                                       |                                     |                                  |
| Numri i fëmijëve   | <b>0</b>                            |                                  |
| no. children / br. Dece                                  |                                     |                                  |
| Numri i njësjive të banimit                              | <b>0</b>                            |                                  |
| no. residential units / broj stambenih jedinica          |                                     |                                  |
| Kategoritë e rrugëve                                     | <b>H, I</b>                         |                                  |
| Road Types / Kategorije puteva                           |                                     |                                  |

Për shkak të mundësive të kufizuara për ndërtim (hekurudha, zgjerimi i rrugës "Bajram Bahtiri", formës së bllokut, etj.) ekonomitë familjare duhet të kompenzohen me ndërtim sipas vendimit përkatës komunal.

Because of limited possibilities for building (railroad, widening of "Bajram Bahtiri" str., the form of the block, etc.) households should be compensated with building as per appropriate municipal act.

Zbog ograničenih mogućnosti za izgradnju (željeznice, proširenja puta "Bajram Bahtiri" oblika bloka, itd.) Kućanstva treba se nadoknaditi prema specifičnoj odluci opštine.

**NR. NGASTRAVE KADASTRALE / NR. PLOTS / BR. PARCLE :**

|        |        |
|--------|--------|
| 3490-0 | 3492-5 |
| 3491-0 | 3493-1 |
| 3492-2 | 3493-2 |
| 3492-3 | 3493-3 |
| 3492-4 | 3494-0 |
| 3492-5 | 7662-1 |



### 3.10 KUSHTET DHE KRITERET PËR MBROJTJE MJEDISORE

#### 3.10.1 Kushtet dhe kriteret për mbrojtjen e mjedisit jetësor

Në përgjithësi kushtet dhe kriteret për mbrojtje mjedisore në lagjen Medrese-Çamëria përcaktohen me ligjet dhe rregulloret relevante në fuqi në Republikën e Kosovës si:

Ligji për ndryshimin e ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003-14 (Ligji nr. 03/L-106)

Ligjin për Planifikim Hapsinor (Ligji nr. 2003/14)

Ligji për mbrojtjen e mjedisit (Ligji nr. 03/L-025)

Ligji për tokat bujqësore (Ligji nr. 02/L-26)

Ligji për ujërat

Ligji për mbeturinat

Ligji për mbrojtjen nga zjarri

Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

Ligji për mbrojtje nga zhurma

Në veçanti në lagjen Medrese-Çamëria kushtet dhe kriteret për mbrojtje mjedisore parashohin:

- Në zonën e lagjes nuk lejohen ato veprimtari që shkaktojnë tym, avull, zhurmë, kundërmim ose pluhur deri në atë masë që të jenë të rrezikshëm, sulmues dhe dëmtoese për shëndet;
- Përgjatë rrugëve përmbledhëse dhe rrugëve lokale duhet të sigurohet korridor gjelbërimi me qëllim të izolimit nga ndotja;
- Të hartohen strategji dhe planet emergjente për mbrojtje të mjedisit kundër – termetit, zjarreve, vërshimeve, erozionit, ndotjes së ajrit dhe të tjera;
- Strategjitë për menaxhimin e mbeturinave duhet të kontrollohen nga komuna në mënyrë të vazhdueshme për ti mënjeluar ndikimet mjedisore;
- Koncepti komunal për mbrojtje mjedisore duhet të hartohet – rregulloret shtesë në nivelin komunal që plotësojnë kornizën ligjore mjedisore nga niveli qendror dhe bëjnë më të lehtë zbatimin e tij. (shih: konventa mjedisore lokale – hartuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës).

#### 3.10.2 Kushtet për lëvizje të lirë për personat me aftësi të kufizuara

Në lagjen Medrese-Çamëria në pronën publike dhe objektet e shfrytëzimit publik duhet të sigurohet qasje dhe lëvizje e lirë për personat me aftësi të kufizuara konform ligjeve dhe rregulloreve në fuqi si dhe standardeve ndërkombëtare në këtë fushë.


### 3.11 KUSHTET DHE KRITERET PËR SHFRYTËZIM RACIONAL TË ENERGJISË

Kushtet e përgjithshme për shfrytëzim racional të energjisë përcaktohen në Ligjin për efikasitetin e energjisë (04/L-016).

Kushtet e veçanta për shfrytëzim racional të energjisë kanë të bëjnë më:

Kushtet për përmirësimin e efikasitetit të energjisë elektrike – Poashtu

Kushtet për kursimin e energjisë elektrike -



Për të gjitha objektet ekzistuese duhet të mirren masa për rritjen e izolimit termik të tyre me qëllim të kursimit dhe shfrytëzimit racional të energjisë.

Të gjitha propozimet për ndërtim të objekteve të reja duhet të prezantojnë skemat për shfrytëzim racional të energjisë dhe duhet të përmbajnë kushtet për kursimin e energjisë.

Banorët e lagjes duhet të inkurajohen për shfrytëzim racional të energjisë përmes programeve komunal dhe më gjerë për përmirësimin e efijencës së energjisë.

## 3.12 KUSHTET URBANE PËR SIPËRFAQET PUBLIKE, PRIVATE SI DHE ELEMENTET PËRCJELLËSE

### 3.12.1 Sipërfaqja e lirë publike

Sipërfaqja e lire publike është sipërfaqja jo e ndërtuar brenda një zone të caktuar urbane shfrytëzimi i së cilës është kryesisht i dedikuar për sheshe, parqe, shirita dhe korridore të gjelbra, sport dhe rekreacion, etj. Këtu po ashtu bëjnë pjesë edhe sipërfaqet ujore. Në shumicën e hapësirave ndërtimi nuk është i lejuar, përveç ndërtimeve të cilat mbështesin aktivitetet që mund të jenë pjesë e sipërfaqeve të gjelbëra.

Në lokacionin e definuar me PRrU është paraparë shtimi i hapësirave të lira publike. Në këtë zonë janë paraparë disa korridore gjelbërimi përgjatë rrugëve primare dhe përgjatë lumit, terrene sportive në kuadër të kompleksit të shkollave të mesme.

Sipërfaqja e lirë publike e klasifikuar me sipërfaqe të gjelbërta / parqe, sport dhe rekreim, shirita gjelbërimi dhe lum do të përfshijë një sipërfaqe prej **18.36 ha** e cila krahasuar me sipërfaqen e lirë publike ekzistuese ka një rritje të dukshme.

Poashtu brenda ngastrave individuale detyrimisht duhet të parashihen sipërfaqe të lira/të pandërtuara si hapësira gjelbërimi rreth 50% e sipërfaqes totale, lojë të fëmijëve, sheshe, etj.

Klasifikimi i sipërfaqeve të lira / të pandërtuara është e ndarë në:

1. Hapësirë e gjelbër
2. Sport dhe rekreim
3. Shirit gjelbërimi
4. Sipërfaqe ujore
5. Gjelbërimi në kuadër të ngastrës

1. Hapësirat e gjelbërta apo parqet e pushimit përfshinë përmbajtje të lojës për fëmijë, shtigje të këmbësorëve, hapësira për piknik dhe rekreim. Kjo hapësirë shtrihet në pjesën VP përgjatë të lumit Prishtevka.

2. Sporti dhe rekreimi në kuadër të hapësirave të lira-parashihen në hapësirën e propozuar për sport dhe rekreim që ndodhet afër xhamisë ekzistuese. Hapësirat për sport dhe rekreim si loja për fëmijë, fusha për sport duhet të parashihen edhe brenda blloqeve të banimit varësisht prej kërkesës së banorëve.




3. Shiritët e gjelbërimit janë hapësira të gjelbërimit të parapara si barriera mbrojtës ndaj zonave të caktuara dhe rrugëve. Shiriti i gjelbërimit  $d=10m$  përgjatë hekurudhës përveç mbrojtjes nga zhurma dhe ndotja në të njëjtën kohë përmirëson pamjen vizuale të rrugës dhe hapësirës përreth. Sipërfaqet e gjelbra në profilet errugës duhet të jetë rezistent ndaj nivelit të lartë të ndotjes. Duhet kontrolluar lartësinë dhe kurorën e tyre në mënyrë që të mos pengohet trafiku.  
Drunjtë e rrugëve duhet të:
  - sigurojnë definimin e profilit;
  - të jenë rezistent ndaj ndotjes dhe pluhurit (me gjethe të mëdha, kurorë të madhe);
  - të mos pengojnë shikueshmërinë.
4. Në zonën e përcaktuar me PRRU ka *sipërfaqe ujore*-lumi "Prishtëvka" që e ndanë lagjen në gjatësi por pjesërisht është i mbuluar dhe shërben edhe si kanalizues i ujërave të zeza dhe hapësira mbi të shfrytëzohet për rrugë të automjeteve. Duke marr parasysh rëndësinë e sipërfaqeve ujore në kuadër të sipërfaqeve të gjelbra dhe vet zonës është planifikuar që ky lum të gjallërohet dhe të potencohet me disa segmente të propozuara. Këto segmente të ujit të përcjellur me gjelbërim mund të jetë oazë pushimi për banorët e zonës poashtu edhe të shëndrohet në vend atraktiv për qytetar.
5. Gjelbërimi në kuadër të ngastrës është i detyruar dhe duhet të parashihet nga secili zhvillues i ngastrës. Raporti i sipërfaqes së ndërtuar përcaktohet varësisht prej etazhitetit, hapësira e gjelbër duhet të përfshijë min 50% të sipërfaqes së përgjithshme. Gjelbërimi i lartë në kuadër të ngastrës duhet të vendoset në mënyrë proporcionale përgjatë qarkullimit të trafikut, oborrit, në hapësirat e parkingjeve dhe në qasjet e parcelës. Pasi që këto hapësira nuk janë publike ato mund të organizohen në kuadër të ngastrave individuale varësisht prej kërkesës së investitorit.

Raporti i hapësirave të pllakëzuara dhe atyre të gjelbërta duhet minimum të jetë 80%:20% në të mirë të sipërfaqeve të gjelbruara në të cilën duhet të jenë rekuizitat për rekreim. Kjo sipërfaqe duhet të jetë e mbrojtur me shirit të gjelbrim të lartë (për mbrojtje nga zhurma dhe ndotja). Në pjesën grafike nuk janë paraqitur hapësirat e tilla.

Kushtet e rregullimit të sipërfaqeve të lira janë:


- Trajtimi i gjelbërimit përgjatë rrugëve;
- Përqindja e sipërfaqeve të gjelbra në ngastër;
- Zonat e përcaktuara për sipërfaqe të lira (vija rregulative, vija ndërtimore, tampongjelbërimi, pjesa e pasme, etj)



### 3.13 KËRKESAT E VEÇANTA, KUSHTET DHE RREGULLORET E DOMOSDOSHME PËR LËSHIMIN E LEJES NDËRTIMORE, SIPAS VENDIT DHE LLOJIT TË OBJEKTIT QË ËSHTË DUKE U NDËRTUAR

#### Leja ndërtimore

- Të interesuarit për ndërtim në lagje duhet të aplikojnë për Leje ndërtimore sipas rregulloreve dhe procedurave të parapara në Komunën e Prishtinës dhe konform Ligjit për ndërtim, Ligjit për Planifikim Hapësinor, dhe ligjeve tjera relevante në Republikën e Kosovës.
- Procesi i ofrimit të lejes apo refuzimit të kërkesë për leje, përfshinë garancinë për rolet transparente të të gjitha palëve me interes (pronarët, ndërmarrjet, palët tjera me interes dhe administrata) do të përmirësohen përmes qartësisimit të procedurave;
- Një bazë adekuate për riparcelizim duhet ta asistojnë procesin e lëshimit të lejeve. Ky aktivitet duhet realizuar në bashkëpunim me drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër;
- Leja ndërtimore mund të lëshohet vetëm pas aprovimit të PRRU të lagjes "Medrese-Çamëri";
- Leja ndërtimore mund të lëshohet vetëm pasi të plotësohen kushtet për vendosjen e veprimtarive të caktuara.



### 3.14 VLERAT ME RËNDËSI NATYRORE, KULTURORE, HISTORIKE SI DHE IDENTIFIKOHEN OBJEKTET PËR TË CILAT ËSHTË E DOMOSDOSHME TË SIGUROHET MBROJTJE OSE KUSHTE TË TJERA TË VEÇANTA PARA FILLIMIT TË RENOVIMIT APO RIKONSTRUIMIT TË TYRE

#### 3.14.1 Vlerat me rëndësi natyrore, kulturore, historike

Gjatë hartimit të Profilit Urban dhe nga shenimet e marra nuk janë evidentuar vlera me rëndësi natyrore, kulturore apo historike në lagjen Medrese-Çamëria.

#### 3.14.2 Objektet në mbrojtje

Sipas deklaratës nga Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës nga Janari i v.2010 asnjë objekt i kësaj lagjeje nuk është në mbrojtje por lagjja ka potencial të pasurisë arkeologjike.

452/10  
9.01.2010

INSTITUTI I MONUMENTEVE  
DHE MUZEU RAJONAL -  
PRISHTINE



INSTITUTE FOR MONUMENTS  
AND REGIONAL MUSEUM OF  
PRISHTINA

19.01.2010  
Prishtinë

Për: Hidroing – DK Prishtinë

Nga: Instituti i Monumenteve dhe Muzeu Rajonal i Prishtinës

Lënda: Përgjigje kërkesës për informata mbiobjektet eventuale të mbrojtura në  
Lagjen "Medrese – Camëria" Prishtinë

Ju informojmë se në lagjen "Medrese – Camëria" nuk ka objekte të mbrojtura nga IMMRP, mirëpo kjo lagje ka potencial për gjetje arkeologjike. Ndërsa, në "Zonën Ekonomike" gjendet Monumenti i Gazimestanit dhe Tyrbja e Bajraktarëve që përfshin sipërfaqe prej 100 hektarësh. Poashtu kjo zonë është potenciale për gjetje arkeologjike.

Komisioni :

Valbona Salluka, Ark

Lindita Çervadiku Dibra, Ark


Miftar Miftari, Historian



Drejtori i IMMRP:

Hagji Mehmetaj

Fig 25 Informata nga IMMR Prishtinë



### 3.15 KUSHTET NË LIDHJE ME MBROJTJEN MJEDISORE NGA LLOJE TË NDRYSHME TË NDOTJES, MBROJTJA E BIODIVERSITETIT, MBROJTJA NGA ZJARRI DHE FATKEQËSITË E TJERA, SI DHE SHKATËRRIMET

#### 3.15.1 Kushtet për mbrojtje nga lloje të ndryshme të ndotjes

Kushtet e përgjithshme për mbrojtje nga lloje të ndryshme të ndotjes përcaktohen me ligjet në fuqi:

- Ligji për mbrojtjen e ajrit nga ndotja (03/L-160)
- Ligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes (03/L-043)
- Ligji për mbrojtjen e bimëve (02/L-95)
- Ligji për mbrojtjen nga zhurma (02/L-102)
- Ligji për mbrojtjen e mjedisit (03/L-025)
- Ligji për mbrojtjen e natyrës (03/L-233)
- Ligji për Mbrojtje nga Rrezatimi Jojonizues, Jonizues dhe Sigurinë Nukleare (03/L-104)

Konform këtyre ligjeve dhe në përgjithësi konform standardeve të krijimit të një mjedisi të shëndoshë, me këtë plan ndalohen të gjitha veprimtaritë që shkaktojnë ndotje të ambientit, përfshi këtu, tokës, ajrit, ujit, shkaktojnë zhurmë apo rrezatim të dëmshëm për shëndetin e njeriut dhe gjallesat në tokë, respektivisht lagjen e përfshirë me këtë plan rregullues.

#### 3.15.2 Kushtet për mbrojtje nga zjarri, fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera

Kushtet e përgjithshme për mbrojtje nga zjarri, fatkeqësite elementare dhe shkatërrimet me ndikim në rregullimin dhe ndërtimin e hapësirës së përfshirë me këtë plan nënkuptojnë përmbajtjen e:


- Ligjit për mbrojtje nga zjarri

##### Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera

- Rregullave për vendosjen e hidrantëve dhe pajisjeve tjera për shuarjen e zjarrit
- Rregullave për instalimet elektrike
- Rregullave për mbrojtjen e ndërtesës ndaj shkarkimeve atmosferike
- Rregullave për ndërtimin e objekteve konform kushteve seizmike

Konform këtyre ligjeve dhe në përgjithësi konform rregullave dhe standardeve të ndërtimit të mbrojtur nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera, me këtë plan ndalohen të gjitha veprimtaritë që rrezikojnë sigurinë e objekteve dhe banorëve të lagjes. Poashtu të gjitha ndërtimet në lagje duhet t'i përmbushin kriteret e sigurisë konform ligjeve dhe rregulloreve të lartpërmendura.





## 3.16 LLOJI DHE KARAKTERI I OBJEKTIT QË MUND TË NDËRTOHET NËN KUSHTET E PËRCAKTUARA ME PLAN OSE NËN KUSHTE TË VEÇANTA

### 3.16.1 Kushtet e përgjithshme për vendosje të ndërtesave të përkohshme

- destinimi i ndërtesave të tilla duhet të jetë jo industri;
- nuk guxon të ketë më shumë se 60 m<sup>2</sup>;
- ndërtesat e përkohshme duhet të kenë strukturë të lehtë, nuk mund të jenë të muratuara nga tullat, betoni ose elemente tjera të forta ndërtimore;
- ndërtesat duhet të jenë montazhe (për të plotësuar kriterin e largimit për 24 orë);
- në një parcelë ndërtimore mund të vendosen disa objekte të përkohshme.

### 3.16.2 Kushtet për vendosjen e ndërtesave

#### 3.16.2.1 Kushte të përgjithshme

- të gjitha ndërtesat e reja duhet ti përmbahen kushteve të lokacionit si: vijës rregulluese, vija ndërtimore, etazhiteti, raporti i sipërfaqes së ndërtuar dhe sipërfaqes së lirë, distanca në mes të ndërtesave, parkimit, gjelbërimit, etj;
- formësimi i strukturës fizike duke respektuar formën perimetrike të blloqeve urbane;
- ndërtesat duhet të projektohen ashtu që t'i përshtaten karakterit dhe kontekstit të rrethit;
- ndërtesat duhet të jenë fleksibile me qëllim të modifikimit dhe rishfrytëzimit të strukturës ekzistuese;
- praktikatat e dizajnit të ndërtesave të gjelbëra (ruajtja e energjisë dhe reduktimi i ndikimit në mjedis);
- ndërtesat e funksioneve të ndryshme dallojnë për nga pjesa ballore e ndërtesës, madhësia dhe forma e ngastrës, volume i ndërtesës, kualiteti i dizajnit, lidhja me funksionet përreth, nevojat e parkimit, hapësira për qarkullim të komunikacionit, dhe peizazhi natyror;
- çdo ndërtesë duhet të ketë vend parkim të duhur;
- çdo ndërtesë duhet të ketë qarkullim efikas.

#### 3.16.2.2 Kushtet për përcaktimin e kotës së përdhësës

Kota e përdhësës së ndërtesës përcaktohet në raport me kotën e niveletës së rrugës publike gjegjësisht në krahasim me kotën zero,

- kota e përdhësës së ndërtesave të reja nuk mund të jetë më e ulët se sa kota e niveletës së rrugës publike;
- kota e përdhësës mund të jetë më së shumti 1.2 m mbi kotën e niveletës së rrugës publike;
- për ndërtesat që në përdhësë kanë tregti apo shërbime, kota e përdhësës mund të jetë më e madhe se kota e trotuarit për max. 0.3 m;
- në raste kur nuk mund të zbatohen këto rregulla, kur terreni është i pjerrët apo në rastet tjera, kota e përdhësës duhet të përcaktohet përmes lejës urbanistike.

#### 3.16.2.3 Ndërtesat e banimit

Banimi ndahet në banim shumëbanesor dhe banim individual.

- *Banimi shumëbanesor* ka njësitë banimore të ngjitura si në horizontale ashtu edhe në vertikale. Lartësia e tyre shkon prej 3 deri në 4 etazhe me



bërthamëtëpërbashkët (komunikim vertikal të përbashkët). Këto ndërtesa mund të kenë parkimbrenda strukturës apo në të hapur.

- *Banimi individual* karakterizohen me një njësi banimore pra shërbejnë vetëm përnjë familje (5 anëtarë mesatarja) dhe lartësia e tyre shkon prej 2 - 3 etazhe. Këtondërtesa mund të kenë parkim brenda strukturës, aneks të strukturës apo në të hapur.

Mundësohet zhvillimi i të disa tipeve të ndërtesave shumëbanesore

- Tipi bllok i ndërtesave, formë kompakte e ndërtesës që rezulton me dendësi të lartë të banimit dhe hapësira e jashtme është më e kufizuar ;
- Tipi linear i ndërtesave, form më e lirë (e hapur) e ndërtesës, ka pak apo nuk ka kufizim të hapësirës së jashtme;
- Banimi shumëbanesor duhet të ketë llojllojshmëri të njërive banimore si banesa njëdhomëshe, dydhomëshe, tridhomëshe dhe banesa katërdhomëshe dhe të planifikohet varësisht prej kërkesave të banorëve. Mirëpo bazuar në mesatarën e anëtarëve të familjes dhe sigurimin e sipërfaqes për banim 18 m<sup>2</sup> per person sipërfaqja me e kërkuar e banesave do të jetë ~85 m<sup>2</sup> netto që janë banesat tri deri katër dhomëshe.

Mundësohet zhvillimi i të gjitha tipeve të ndërtesave të banimin individual

- Tipi i veçantë i shtëpisë;
- Tipi i shtëpisë dyshe (dy shtëpi të ngjitura);
- Tipi i shtëpisë në varg (tre a më shumë shtëpi të ngjitura);

### 3.16.2.4 Ndërtesat afariste (Ndërtesat e punës)

Ndërtesat afariste janë struktura të dedikuara për punë, tregti ose hulumtim dhe kanë këto karakteristika të përbashkëta:

- Baza të kateve të përsëritura
- Hapësira të hapura dhe fleksibile
- Bërthama që përmban liftin, shkallët, sistemet mekanike të ndërtesës dhe elementetjera të përbashkëta.

Afarizmi ndahet në veprimtari tregtare & zejtare, ndërtesa shërbyese (zyre) dhe në veprimtari hotelierike (restaurante, bare, hotele).

- Veprimtaritë afariste mund të vendosen në një ndërtesë të përbashkët ose në ndërtesë të veçantë.
- Preferohet përzjerja e veprimtarive afariste në një ndërtesëKushtet e veçanta të hapësirave për zyre
- Orientimi varet nga lokacioni, preferohet aksi lindje—perendim;
- Dimensionet tipike të bazës së planimetrisë janë 45m x 36m dhe 60m x 45m ;
- Ndërtesa sa më fleksibile për organizim me mundësi të lëvizjes së murreve tëbrendshme;
- Lartësia dysHEME-dysHEME për zyre është 2.7 m deri 3.6 m;
- Distanca në mes të bërthamës (komunikimi vertikal) dhe skajit të ndërtesës duhet tëjetë 25 m;
- Distanca në mes të dy bërthamave duhet të jetë 50 m;
- Sigurimi i ndriqimit dhe ventilimit të mirë;
- Qasje për parkim (parkim nëntokësor) dhe hyrje ekonomike (doku për furnizim);
- 1 parkingj për 30m<sup>2</sup> të ndërtesës;
- Shenjëzim i kuptueshëm dhe dizajn unik i hyrjes.



### 3.16.2.5 Kushtet e veçanta të hapësirave për tregti

- Lartësia dysheme-dysheme për tregti është 3.6-5.4m me mundësi të vendosjes së kablllove dhe sistemeve tjera të ndërtesës;
- Qasja e vizitorëve në ballë dhe qasja e kamionëve anash;
- Shfrytëzimi efikas i hapësirës (hapësira në mes të shtyllave 6.4 m e rritë fleksibilitetin)
- Rampat për kamion duhet të jenë max. 5%

### 3.16.2.6 Ndërtesat e institucioneve publike

Në lokacionin e përcaktuar me PRrU janë planifikuar këto përmbajtje sociale:

- 3çerdhe/kopështetë fëmijëve në pronësinë publike afër objekteve arsimore. Çerdhe/kopështe tjerajanë të mundshme në blloqet e banimit;
- një qendër-sallë polifunksionalenë pronësinë publike;
- qendra e lagjesme përmbajtje të ndryshme publike, shërbime komunale, postë, qendër komuniteti, qendër rinore etj.
- parcela të reja për banim individual në pronësinë publike;
- objektet ekzistuese arsimore do të ruhen;
- objekti i kultit - xhamia do të ruhet

Zhvillimi i mirëfillt i lagjes së Medresë duhet të shoqërohet me një aplikim adekuat të infrastrukturës sociale për banorët e tanishëm dhe ata që do vinë. Në mungesë të shënimeve të sakta statistikore, për vlerësimin e kërkesave për infrastrukturën sociale skica e llogaritjes është bërë me supozim, vlerat e përgjithshme në nivel shtetëror dhe formula për llogaritje demografike.

Duke u bazuar në këto supozime dhe në sipërfaqen e mundshme të ndërtimit suposohet se në lagjen "Medrese-Çamëri" do jetojnë rreth 22,726 ban.

Duke llogaritur në bazat e madhësive standarde, numrin e fëmijëve në përkujdesjen e nevojshme edukative rrjedh se fitojmë këto të dhëna:


Tab.9 Numri i objekteve edukativo-arsimore

| totali i banorëve: 30,477     |                    |            |        |   |   |                                   |                                      |                         |                  |                 |
|-------------------------------|--------------------|------------|--------|---|---|-----------------------------------|--------------------------------------|-------------------------|------------------|-----------------|
| seksioni i edukimit dhe moshë | nr. fëm. /1000b a. | nr. i fëm. | turnet | Sip. parcelës për fëmijë (m <sup>2</sup> /fëmijë) | gjithësej Sip. parcelës (m <sup>2</sup> ) | Sip. e objektit (m <sup>2</sup> ) | Sip. tot.e objekt. (m <sup>2</sup> ) | m <sup>2</sup> / fëmijë | Fëmijë në objekt | Nr. ob. të nev. |
| Çerdhe & Kopesht (0-6 v.)     | 70                 | 2133       | 1      | 20  | 42,667                                    | 1,000                             | 10,667                               | 5                       | 200              | 11              |
| Edukimi Fillor (6-12 v.)      | 180                | 5486       | 2      | 12  | 32,915                                    | 4,800                             | 16,457                               | 6                       | 800              | 3               |
| Mesme (12-18 v.)              | 50                 | 1524       | 2      | 13  | 9,905                                     | 3,000                             | 4,572                                | 6                       | 500              | 2               |
| totali i fëmijëve:            |                    | 9143       | 1-2    | 12-20   | 85,487                                    |                                   | 31,696                               | 5-6                     |                  | 16              |

Nga keto koeficienta perfundojmë se nevojiten rreth 8 objekte parashkollore por duke marrë në konsideratë gjendjen aktuale të objekteve dhe pronësisë kemi përcaktuar min. 3 objekte që do e mbulojnë nevojën minimale të banorëve.

#### Sheshet e lojrave dhe paisjet sportive

Në përputhshmëri me standardet gjenerale të planifikimit urban një sipërfaqe prej 1m<sup>2</sup> e sheshit për lojë për banorë për fëmijët e moshës 3-11 vjeç është e nevojshme. Sheshet e lojrave duhet të jenë pjesë integrale e fqinjësisë në formësimin



e blloqeve të vogla të banimit. Sheshet e lojrave do të integrohen çdokund brenda zonës së banimit dhe atë mikse. Sa i perket paisjeve sportive që duhet të jetë 1.5m<sup>2</sup>/ban. Edhe këto do të organizohen në njësitë e bllokut e disa prej tyre do të jenë të grupuara në hapësirat e shkollave që të mund të shfrytëzohen edhe nga komuniteti.

Kushtet e veçanta për çerdhe / kopësht:

- Siperfaqja e lokacionit 25m<sup>2</sup>/femije ose 0.25-0.3ha;
- Hyrja për në ndërtesë duhet të sigurohet nga rruga e brendshme-për qasje;
- Çerdhe (fëmijë 8 muaj-3 vjeç) duhet të jenë grupe prej 6-8 fëmijë me sipërfaqe 2-3m<sup>2</sup> / fëmijë;
- Kopshti (fëmijë 3 vjeç-6 vjeç) duhet të jenë grupe prej 25-30 fëmijë me sipërfaqe 1.5-3m<sup>2</sup> / fëmijë;
- Qendra për kujdes të fëmijëve mbas shkollës (fëmijë 6 vjeç—15 vjeç) duhet të jenë grupe prej 25—30 fëmijë me sipërfaqe 1.5-4m<sup>2</sup> / fëmijë;
- Dhoma për një grupi fëmijësh duhet të jetë min. 60m<sup>2</sup>;
- në zonat urbane ndërtesa preferohet të jetë me 2 etazhe;
- Minimum 6 vend parkingje dhe hapësirë për biçikleta dhe karroca
- Hapësira minimale për lojë të fëmijëve është 40 m<sup>2</sup> (5 m<sup>2</sup> për njësi banimi);
- Hapësira për lojë duhet të jetë e mbyllur / e kufizuar me barierë min. 1 m me qëllim të mbrojtjes nga rruga, veturat e parkuara, uji dhe burimeve tjera të rrezikut.

Tab.10 Normativa per infrastrukturen sociale


| grup mosha | sipërfaqja | distanca nga shtëpia |          |
|------------|------------|----------------------|----------|
|            |            | (m)                  | (minuta) |
| 0-6        | 0.6        | 110-230              | 2        |
| 6-12       | 0.5        | 350-450              | 5        |
| 12-18      | 0.9        | 700-1000             | 15       |

- Hapësira për lojë varet edhe nga grup mosha, sipërfaqja e shfrytëzuar për person, etj.

### 3.16.2.7 Hapësira e parkimit

Secila ngastër individuale duhet të ketë parkim të mjaftueshëm për të zhvilluar veprimtarinë e saj;

- Veprimtaritë e banimit duhet të kenë 1 parking për njësi banimore;
- Veprimtaritë e afarizmit duhet të kenë 1 parking për 30 m<sup>2</sup> të ndërtesës;
- Institucionet shkollore duhet të kenë 2 parkingje për 100m<sup>2</sup> të ndërtesës;
- Institucionet parashkollore duhet të kenë 1 parking për 20 fëmijë;
- Institucionet shëndetësore duhet të kenë 1 parking për 30 m<sup>2</sup> neto të ndërtesës;
- Parkingjet e hapura preferohet të vendosen mbrapa ndërtesave;
- Parkimi i mbyllur nën strukturën e ndërtesës mund ta tejkaloj sipërfaqen bruto të bazës (sipërfaqen e shputës);



### 3.17 LLOJI DHE SHFRYTËZIMI I OBJEKTIT, NDËRTIMI I SË CILIT ËSHTË I NDALUAR NË ZONA TË ÇAKTUARA

Në tërë lagjen Medrese-Çamëria të përfshirë në këtë plan rregullues ndalohet ndërtimi i çdo lloj objekti që nuk i përmbush kriteret e mbrojtjes së mjedisit (Kapitulli 3.10) dhe mbrojtjes nga ndotja dhe fatkeqësitë (Kapitulli 3.15).

### 3.18 POZITA E OBJEKTIT NË PARCELË DHE NË KUADËR TË PARCELAVE FQINJE

Objekti realizohet brenda një parcele ose grup parcelash që janë grupuar me marrëveshje paraprake të pronarëve për realizimin e objektit të tillë. Objekti nuk guxon të shkelë parcela të huaja, as në hapësirën ajrore e as nëntokë.

Objekti ndërtohet vetëm brenda vijës ndërtimore dhe nuk guxon të shkelë vijën ndërtimore. Daljet jashtë vijës ndërtimore janë të lejuara për katet mbi përdhësë, për ballkone, strehë etj. me gjatësi të daljës max. 1.4m.

Pozita e objektit në parcel (ose grup parcelash) vendoset në atë mënyrë: që të mos cenojë parcelat fqinje dhe vijën rregulluese të kësaj distancë të mjaftueshme nga objektet fqinje.

Gjatë ndërtimit të objekteve të reja, pa dallim funksionit të tyre, duhet siguruar që të mos rrezikohen kushtet e jetesës së banorëve si dhe stabiliteti i objekteve në parcelat fqinje dhe rrethinë. Gjatë ndërtimit të objekteve të reja duhet të planifikohen distanca të mjaftueshme me objektet fqinje në mënyrë që të mos dëmtojë funksionin e tyre, kushtet e diellosjes, etj. Pozita dhe lartësia e objekteve të reja në raport me rrethinën duhet të jetë e tillë që të mos pengojë ndricimin e drejtpërdrejtë ditë diellor të objekteve në rrethinë, më gjatë se sa gjysma e kohëzgjatjes së këtij ndriçimi siç shihet në propozimet në vazhdim:

Fig 26 Koncepti i zhvillimit të lagjes



<sup>3</sup>Pjesë nga prezentimi në Kuvend me dt. 29.12.2011



Fig 27 Koncepti i zhvillimit të lagjes



<sup>4</sup>Pjesë nga prezantimi në Kuvend me dt. 29.12.2011





Fig 28 Koncepti i zhvillimit të lagjes



<sup>5</sup>Pjesë nga prezantimi në Kuvend me dt. 29.12.2011



### 3.19 LARTËSIA E OBJEKTEVE

Lartësia e objekteve përcaktohet me numrin e kateve (etazheve) për secilin bllok veq e veq, në bazë të koeficientave të shfrytëzimit të parcelës, dhe koeficientit të ndërtimit.

Për objektet e banimit lartësia e katit të banimit mund të jetë prej 2.7-2.95m. Lartësia e lirë (hapësirë drite) nuk mund të jetë më e vogël se 2.5m për katet e banimit. Për katin përdhësë me funksion afarizëm lartësia e lirë (hapësirë drite) minimale është 3.0m.

Objektet e infrastrukturës sociale kanë lartësi të kateve në varshmëri prej funksionit të tyre dhe standardeve të projektimit të objekteve të tilla.

Lartësia e objekteve të reja në raport me rrethinën duhet të jetë e tillë që të mos pengojë ndriqimin e drejtpërdrejtë ditë diellor të objekteve në rrethinë, më gjatë se sa gjysma e kohëzgjatjes së këtij ndriqimi (3.18).

### 3.20 DISTANCA MË E VOGËL NDËRMJET OBJEKTEVE

Distanca e objektit në raport me rrugën përcaktohet me vijën ndërtimore sipas kategorisë së rrugës.

Distanca më e vogël ndërmjet dy objekteve me fasadë ballore përballë njëri-tjetrit, orientimi very- jug, është  $1.5H$  – ku  $H$  është lartësia mesatare e këtyre dy objekteve.

Distanca e objekteve shumëbanesore në varg, në fasadën anësore është min. 4m. Objektet shumëbanesore mund të ndërtohen në varg me distancë zero në fasadën anësore me kusht që cdo 60m të ofrohet pasazhi për depërtimin e makinës për zjarrfikje.

Distanca e objekteve individuale në varg mund të jetë zero (për shtëpitë në varg). Vargu ndërpritet cdo 7 njësi (pas cdo të shtatës shtëpi në varg) me hapësirë prej min 4m, me qëllim të mundësisë të ndërhyrjes përreth objekteve me makinën për zjarrfikje.


### 3.21 KUSHTET PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE TË TJERA NË PARCELËN E NJËJTË NDËRTIMORE

#### 3.21.1 Kushtet për ndërtimin e objekteve tjera

Ndërtimi i objekteve tjera në parcelën e njëjtë ndërtimore lejohet për:

- objektet e karakterit të përkohshëm
- objektet e ndërtimit të ulët pa mbulesë / kulm.
- Objektet utilitare si garazha, depo etj, kur ato nuk tejkalojnë koeficientat e lejuar të sipërfaqes së ndërtimit.





### 3.21.2 Kushtet për vendosje të elementeve mikro-urbane

- a. kiosqet / makina të shitjes, bankomatet apo paisje tjera
  - nuk mund të jenë të muratuar nga tullat, betoni ose elemente tjera të ngjashmëndërtimore;
  - objektet duhet të jenë montazhe (për të plotësuar kriterin e largimit për 24 orë);
  - vendosen në zonë e trotuarit me kushtin themelor për të mos penguar lëvizjen e lirë të këmbësorëve;
- b. shenjat dhe panotë informuese
  - duhet të shërbejnë për orientim brenda zonës si dhe për identifikimin e vet ndërtesës
  - shenjat apo panotë informuese që identifikojnë ndërtesën duhet të vendosen në zonën e shiritit të gjelbërt brenda ngastrave mbas vijës rregulluese me qëllim që të mospengojnë shikueshmërinë në trafik dhe të jenë të dukshme nga shtigjet e këmbësorëve;
  - shenjat apo panotë informuese që identifikojnë tërë zonën ose pjesë të caktuara të zonës duhet të vendosen në zonën e trotuarit (hapësirën publike) me kusht që të mospengojnë lëvizjen e lirë të këmbësorëve ose mund të vendosen në shiritin e gjelbërpërgjatë rrugës;
- c. mobiliari
  - bankat për ulje duhet të vendosen në zonën e trotuarit me kushtin themelor për të mospenguar lëvizjen e lirë të këmbësorëve, poashtu ato mund të vendosen në shiritin egjelbër përgjatë rrugës të kthyer kah trotuari;
  - ndriçimi vendoset çdo 30m përgjatë gjithë rrugëve dhe duhet të ketë shtyllat jo më të larta se 6m;
  - kontejnerët e mbeturinave për shërbime të ngastrave individuale, trafostacionet, matësit e ujit dhe elektrikës duhet të mëshifen aty ku është e mundur, aty ku nuk është e mundur duhet të jenë në harmoni me pejsazhin.

## 3.22 KUSHTET DHE MËNYRAT E SIGURIMIT TË HYRJES NË PARCELË DHE NË HAPËSIRËN E PARKINGUT

Kushtet për qasje automobilistike në ngastër janë:

- kyçja në ngastër nga rruga përmbledhëse (Kat.III) duhet të jetë min.50 m nga rruga tjetër ;
- kyçja në ngastër nga rruga locale (Kat.IV) duhet të jetë min. 30 m nga rruga tjetër;
- kyçjet në ngastër nga rruga për qasje (Kat.V) nuk është e kufizuar;
- Duhet të sigurohet qasje e përkohëshme për ato ngastra të cilat nuk plotësohen kushtet e lartëcekura. Qasja e automjetit me rampë (max. 10%) në garazhë nëntokësore duhet të filloj min. nga vija ndërtimore;
- Qasja e automjetit në parking të hapur duhet të siguroj një distancë minimale 2.75m të qarkullimit;
- Duhet të mundësohet qasja e automjetit të zjarrëfikësëve çdo 50 m dhe për çdo objekt.
- Duhet të mundësohet qarkullimi për lëvizjen e lirë të automjetit të zjarrëfikësëve me distancë min. 4 m (pasazh apo rrugë e hapur);



- Duhet të sigurohet lartësia e pastër prej 4 m në pasazhe të ndërtesave për qarkullim të lirë të zjarrëfiksëve.

### 3.23 KUSHTET PËR DEFINIMIN E RRETHOJAVE

Parcelat ndërtimore të ndërtesave shumëbanesore dhe ndërtesave me destinimit publik nuk duhet të rrethohen dhe ato janë përcaktuar sipas rregullave me këtë plan:

- nuk lejohet rrethimi i parcelës me gardh të ndërtesat shumëbanesore;
- nuk lejohet rrethimi i parcelës me gardh në ndërtesat publike përveç institucioneve parashkollore dhe shkollore;
- duhet të largohet gardhi apo muri kufizues i shtëpive individuale nëse pengon zgjerimin rrugës publike;
- duhet të largohet gardhi apo muri kufizues i ndërtesave private nga hapësira publike (uzurpimi i hapësirës publike)

Parcelat ndërtimore të ndërtesave të banimit individual dhe ndërtesave arsimore mund të rrethohen sipas rregullave të përcaktuara me këtë plan:

- lejohet rrethim me gardh të shtëpitë individuale deri në lartësi 1.2 m (nga koha e trotuarit);
- gardhi duhet të vendoset në vijën rregulluese, në formë që shtyllat e gardhit të gjenden brenda parcelës ndërtimore që rrethohet;
- dyert duhet të hapen brenda parcelës;
- gardhet të cilat janë të ndërtuara dhe të cilat dalin nga rregullat e përcaktuara me këtë plan duhet të ndryshohen me qëllim të ruajtjes së interesit të përgjithshëm (siguri, dukje estetike, higjienë, etj).

### 3.24 FORMËSIMI ARKITEKTONIK DHE ESTETIK I ELEMENTEVE TË ÇAKTUARA TË OBJEKTIT (MATERIALEVE, FASADAVE, KULMEVE, ETJ.)

Me qëllim të sigurimit të harmonisë së tërësisë urbane dhe krijimit të relacionit të shëndoshë mes ndërtesave dhe vendit duhet respektuar rregullat si më poshtë.

- kulmi mund të jetë i pjerrët apo i rrafshët;
- këndi maksimal i kulmit të pjerrët mund të jetë 35° (te ndërtesat shumëbanesore kulmisygjerohet të mbulohet me parapet);
- nuk lejohet aplikimi i kulmit mansard;
- përdhësa preferohet të hyjë brenda vijës ndërtimore për min. 2m, duke krijuar këshu strehë pranë lokaleve dhe shteg më të gjërë të këmbësorëve;
- inkurajohet përdorimi i materialeve natyrore (tulle, gurë, e të ngjashme);
- nuk lejohet përdorimi i ngjyrave bazë, të cilat mund të jenë intensive (të papërziera mengjyra tjera apo shkallë të përhimtë) ose të zbutura (ngjyra bazë e zbutur me ngjyrën e bardhë), inkurajohet përdorimi i ngjyrave pastelesh, ose të ngjashme;
- materialet me refleksion të madh si dritaret-pasqyrë dhe të kaltërta nuk është mirë të përdoren. Këto mund të përdoren si material sekondare apo për aksentimin e ndërtesës;



- karakteristikat arkitektonike si hyrjet dhe strehët e potencuara, të dalat në mure, fasadae xhamit, etj; hapësira të parkimit të gjelbëruara; pejsazhe të dizajnuara mire dhe fontana apo elemente tjera ujore është mirë të përdoren;
- inkurajohet arkitektura e thjeshtë, e pastër, pa shumë detaje.

### 3.25 KUSHTET PËR RENOVIM DHE RIKONSTRUIM TË OBJEKTEVE EKZISTUESE

#### 3.25.1 Ndërtesat ekzistuese në parcellë

- nëse ndërtesa ekzistuese e kalon vijën rregullative, dhe gjendet në koridorin erregullimit, ajo duhet të rrenohet tërësisht apo pjesërisht (pjesa që shtrihet në koridorin e rregullimit);
- ndërtesat problematike që vështirësojnë zgjerimin e rrugëve publike nuk guxojnë të rrenohen pa marrëveshje me pronarët;
- ndërtesat ekzistuese që nuk janë në vijën ndërtimore (mbesin mbrenda ose dalin jashtë vijës ndërtimore), mund të mbahen në gjendjen ekzistuese, por pamundësohet mbindërtimi, aneks ndërtimi apo ndërtimi i ri në po të njëjtën bazë;
- nëse në kuadër të ndërtesës ekzistuese (parcelës së njëjtë) ndërtohet ndërtesë e re, atëherë ajo ndërtesë duhet t'i plotësoj kushtet e përgjithshme të rregullimit (raporti isipërfaqes së ndërtuar dhe sipërfaqes së lirë, distanca në mes të ndërtesave, etj);

#### 3.25.2 Intervenimet në ndërtesa

Pa kërkesë për leje mund të lejohet për:

- renovim, sanim dhe ndërrim i elementeve konstruktive, brenda gabaritit ekzistues (sanim dhe ndërrim i elementeve konstruktive nuk lejohet për ndërtesat që pengojnë zgjerimin e rrugës publike);
- kyçja në instalimet komunale, ose rekonstruimi i instalimeve të tilla;
- aneks-ndërtimi për zgjerimin e ndërtesës duhet të parashihet vetëm nëse nuk tejkalohet indeksi i sipërfaqes së shputës;
- adaptim i hapësirës brenda gabaritit ekzistues.

#### 3.25.3 Objektet që atakojnë rrugët

Realizimi i rrugëve të propozuara në këtë plan do ishte një zgjidhje e madhe dhe afatgjatë për banorët e kësaj lagjeje dhe lagjeve fqinje, për një të ardhme më të mirë. Janë ruajtur maksimalisht rrugët ekzistuese por është bërë zgjerimi i tyre në mënyrë që të plotësohen standardet dhe normativat si dhe janë hapur disa rrugë të reja që janë të domosdoshme për funksionimin e lagjes. Janë analizuar objektet që takohen nga trotuari ose nga rruga që janë gjithësej 397 ku shumica e tyre janë P+0 ose P+1. Nga rrugët e kategorisë I, II, III dhe IV atakohen 245 objekte ndërsa nga rrugë e brendshme të blloqeve 152 objekte. Sipërfaqja totale në Përdhese e objekteve që atakojnë rrugët është rreth 35.000m<sup>2</sup>. Gjatë analizës së objekteve që atakojnë rrugët janë përjashtuar objektet që prekin trotuarin deri në 50cm.

Kompenzimi i objekteve që atakojnë rrugët dhe objekteve tjera që rrenohen për realizimin e rregullimit urbanistik të lagjes të propozuar me këtë plan duhet të bëhet në procedurë të rregullta dhe me vendim komunal.





Figura 29 Objektet që atakojnë rrugët



### 3.26 KUSHTET E VEÇANTA PËR NDËRTIM TË OBJEKTEVE

Në raport me funksionin e objektit përkatës për të cilin lejohet ndërtimi në zonë, duhet të përshkruhen kushtet e veçanta për ndërtimin e tij, në raport me kërkesat e këtij plani, dhe organeve përkatëse.

Me kërkesën e autoriteteve komunale dhe IMMR mund të kërkohej të kryhen hulumtime arkeologjike për lokacione të caktuara, në rast se paraqitet nevoja, apo ka indikacione për gjetje arkeologjike.

Për objektet e ndërtuara përgjatë hekurudhës duhet të mirren masa shtesë për mbrojtje nga zhurma. Objektet duhet të realizohen me fasadë dhe hapje të izoluar mirë nga ana e hekurudhës.

### 3.27 DENDËSIA E BANIMIT DHE DENDËSIA E NDËRTIMIT SIPAS STANDARDEVE

#### 3.27.1 Shtimi demografik i lagjes

Sipas Planit Strategjik Shtimi i përgjithshëm vjetor është 2,60221 % ose 26 në 1.000 banorë. Mesatarja e shtimit natyror (lindjet 18 – vdekjet 4) është 14 në 1.000 banorë.

Bilanci vjetor i migrimit është 12 në 1.000 banorë

Nga 85% të anketuarit e lagjes janë evidentuar rreth 6340 banorë të lagjes, nëse e shtojmë duke supozuar përqindjen e ngelur rrjedh se nr. ekzistues i banoreve në lagjen e Medrese-Çamëri është rreth 8000 banore.

Duke u bazuar në të dhënat ekzistuese dhe në parashikimet demografike rrjedh se në lagjen e Medresesë deri në vitin 2030 do kemi këtë rritje të popullsisë: Shtimi i popullsisë nga shtimi natyror do të jetë 10.429 në v. 2020 dhe 12.465 në v.2030;

Plani rregullues urban Medrese-Çamëria sipas zgjidhjes së prezentuar parashesh zhvillimin e lagjes me kapacitet prej rreth 30.000 banorësh që do të thotë se mbulon nevojat për banim në lagje për së paku 50 vitet e ardhshme.

#### 3.27.1.1 Dendësia e popullsisë

Rritjen e dendësisë së popullsisë e shkakton shtimi intenziv i popullsisë, migrimi i popullsisë, zhvillimi ekonomik, rritja e popullsisë në qytete. Dendësia e banorëve në lagjen Medrese-Qamëria planifikohet të jetë maksimalisht 260 ban/ha.

Dendësia banimore e propozuar rezulton me densifikim të lagjes dhe kjo mjafton për mbulimin e nevojave për banim në lagje në 20 vitet e ardhshme e më shumë. Dendësia banimore ndryshon varësisht prej këtyre raporteve të përcaktuar në tabelën e më poshtme.

Tab.11 Dendësia e blloqeve

| Zona | ETAZHITETI MAKSIMAL | SIPËRFAQJA BRUTO E BAZËS | SIPËRFAQJA E LIRË | INDEKSI MAKSIMAL I NDËRTIMIT | DISTANCA MIN. NË MES NDËRTESAVE ME HAPJE |
|------|---------------------|--------------------------|-------------------|------------------------------|--|
| ZM   | P+4                 | 40%                      | 60%               | 2.0                          | 15.0 – 19.5 m                            |
| ZB   | P+2                 | 40%                      | 60%               | 0.9                          | 11.5 - 15.0 m                            |



## 3.28 KUSHTET QË KANË TË BËJNË ME HAPËSIRAT E LIRA TË CILAT DUHET TË MIRËMBAHEN NË APO PËRRETH NDËRTESAVE

### 3.28.1 Rregullimi i hapësirave të lira / gjelbrimit

Prishtina ka 3.8 m<sup>2</sup> sipërfaqe të gjelbëruara për banorë, që është gati dhjetë herë më pak se nga rekomandimet dhe standardet botërore. Duhet që ky raport të përmirësohet dhe sipërfaqet ekzistuese të gjelbëruara të mbrohen nga ndërtimi i çdo lloj objekti, kiosku ose platoje.

Funksioni i sipërfaqeve të gjelbëruara është ajrosja e qytetit dhe përmirësimi i kushteve për jetë dhe punë në të.

Me PRRU Medrese-Qamëria është bërë mbrojtja e fondit ekzistues të gjelbërimit dhe sipërfaqeve të destinuara për gjelbërim, pasurimi i sipërfaqeve ekzistuese, ngritja e gjelbërimit dhe raporti i rregullt me ato me qëllim të rritjes së karakteristikave funksionale dhe vizuale. Me gjelbërimin e shesheve, kryqëzimeve fitohet numër i madh i sipërfaqeve të vogla gjelbëruese të cilat e pasurojnë, hijeshojnë, pastrojnë dhe lidhin qytetin. Sipërfaqete gjelbëruara nuk duhet të pengojnë komunikacionin me zvogëlimin e shikueshmërisë. Programi i masave për mirëmbajtjen dhe kujdesin e sipërfaqeve të gjelbëruara duhet të bëhet në bashkëpunim me institucionet e kualifikuara.

Lagjja "Medrese-Çamëri" ka sipërfaqe prej 86.9ha, dhe gjindet në afërsi të qendrës së kryeqytetit.

#### 3.28.1.1 Funksioni ekologjik dhe rekreativ i hapësirave të gjelbërta

Sipërfaqja e gjelbërt e paraparë në këtë lagje është më shumë e shpërndarë në njësi të blloqeve të banimit sesa në hapësira publike të mëdha ashtu që në total mbulon një sip. prej 42.32 ha që i bie rreth 43% të totalit të sipërfaqes së lagjes ose rreth 18 m<sup>2</sup> për banorë që është një standard shumë i mirë.

|  |                 |
|--|-----------------|
| Sip. Gjelb. në blloqet mikse dhe të banimt | 23.96 ha        |
| Sip. gjelb në hap. publike                 | <u>18.36 ha</u> |
| Sip. tot.e gjelb.                          | 42.32 ha        |


Kjo hapësirë e gjelbërt e lagjes do të krijojë një mikroklimë të përshtatshme për banorët dhe vizitorët e kësaj lagjeje.

Do të aplikohet stili gjeometrik dhe peisazhor i gjelbërimit, përgjatë disa rrugëve, brendësisë së blloqeve, parqeve, etj.

Zgjedhja e tipit të bimëve janë elemnet shumë i rëndësishëm që varen nga kushtet klimatike dhe pedologjike.

#### 3.28.1.2 Sipërfaqet e gjelbëruara në blloqet e banimit

Me organizimin e kësaj hapësire do të mundësohet pushimi dhe rekreacioni brenda blloqeve për të gjitha kategoritë e banorëve. Rëndësi të veçantë duhet t'i kushtohet që me bimë të larta të pengohet rrymimi i ajrit dhe mos të krijohet hije shumë e madhe brenda blloqeve. Me kombinimin e sipërfaqeve të pllakosura dhe të gjelbëruara organizohen këndet e lojërave për fëmijë, këndet e qeta dhe këndet për rekreacion.



Gjatë ndërtimit të gjelbërimit në qytet duhet pasur parasysh largësinë e përshtatshme të bimëve dhe shkurreve nga instalimet nëntokësore.

Tab.12 Largësia e gjelbrimit nga instalimet

| instalimi nëntokësorë          | largësia nga pemët (m) | largësia nga shkurret (m) |
|--------------------------------|------------------------|---------------------------|
| ujësjellësi                    | 2                      | 1                         |
| traseja e ujësjellësit kryesor | 5                      | 5                         |
| ngrohja                        | 3                      | 2                         |
| elektrika                      | 3                      | 2                         |
| telefoni                       | 2                      | 2                         |
| kolektori                      | 3                      | 2                         |
| kanalizimi                     | 2                      | 1                         |
| kanalizimi atmosferik          | 1                      | 0.5                       |
| drenazhimi nën tokë            | 2                      | 1                         |

### 3.28.1.3 Trajtimi i gjelbërimit përgjatë rrugëve


- Me PRRU shirit i gjelbërimit nënkuptohet ale e drunjëve me hapësirë të caktuar të gjelbërimit të ulët;
- Hapësira e gjelbërimit të ulët përgjatë shiritit të gjelbërimit paraqet bazament për mbjelljen e drunjëve.
- Shiriti i gjelbërimit duhet të vendoset përgjatë rrugëve primare me gjërësi 1.0 m. Ky shirit kryesisht vendoset në të dy anët e rrugës (2x1.0m=2.0m);
- Distanca në mes të drunjëve duhet të jetë minimum 6 m.

### 3.28.1.4 Hapësirat e gjelbërta dhe krijimi i shesheve të reja

- Hapësirat e gjelbërta dhe parqet e pushimit mund të krijohen brenda blloqeve tëbanimit varësisht prej nevojës dhe kërkesës së pronarëve;
- Sheshet mund të krijohen brenda blloqeve të banimit varësisht prej nevojës dhe kërkesës së pronarëve.

### 3.28.1.5 Hapësirat e sportit dhe rekreimit

- Hapësirat e sportit dhe rekreimit të propozuara në bllokun F2/1 plotësojnë nevojat optimale për banorët e lagjes;
- Hapësirat e sportit dhe rekreimit mund të krijohen edhe brenda blloqeve të banimit varësishtprej nevojës dhe kërkesës së pronarëve;
- Hapësirat e sportit dhe rekreimit në objektet e shkollave gjithashtu mund të shfrytëzohen nga banorët e lagjes.



### 3.28.1.6 Trajtimi i sipërfaqeve ujore

- Lumi "Prishtëvka" duhet të trajtohet dhe të bëhet rregullimi i tij sipas parametrave dhe standardeve të kohës.+

### 3.28.1.7 Përqindja e sipërfaqeve të gjelbëra në ngastër

- Gjelbërimi në kuadër të ngastrës është i detyruar dhe duhet të parashihet nga secilzhvillues i ngastrës apo grup i tyre;
- Raporti i sipërfaqes së shputës dhe të pandërtuar më së shumti është 40% - 60%.

### 3.28.1.8 Tipet specifike të bimëve

- Së paku një dru me kurorë të gjërë duhet të mbillet për 500 m<sup>2</sup> të sipërfaqes së pandërtuar të zonës;
- Sugjerohet mbjellja e bimëve autoktone, që i përshtaten klimës dhe vendit;
- Trupat ekzistues të drunjëve nëse është e mundur duhet të ruhen;
- Duhet të parashihet largësia e duhur e drunjëve me rrënjë të mëdha nga instalimet nëntokësore.


### 3.28.1.9 Faktorët kryesor që ndikojnë në zgjedhjen e bimëve

- Kushtet klimatike – kanë ndikim gjatë zgjedhjes së bimëve dekorative sepse disa prej tyre nuk durojnë temperaturat minimale që mbizotërojnë në këtë zonë.
- Kushtet pedologjike – poashtu duhet bërë analizë e dheut në të gjithë sipërfaqen e kompleksit që të zgjidhen bimë që mund të adaptohen në kushtet ekzistuese pedologjike të kompleksit. Një element tjetër i rëndësishëm në zgjedhjen e drunjëve që parashihen të mbillen përgjatë rrugëve apo afër objekteve është gjerësia e kurorës dhe sistemi rrënjësorë. Nëse gjerësia nuk është adekuate degët e tyre mund të paraqesin pengesë për objektet përreth dhe poashtu mund të pengojnë qarkullimin e lirë të automjeteve kurse të bimët dekorative me zhvillim të rrënjëve në drejtim horizontal mund të dëmtojnë asfaltin e rrugëve apo trotualet. Pra, në këto raste duhet zgjedhur drunjë të cilët nuk arrijnë lartësi mbi 10 metra dhe që kanë një sistem të rrënjëve që zhvillohet kryesisht në thellësi të tokës.

## 3.29 KUSHTET E KYÇJES NË INFRASTRUKTURË (P.SH. FURNIZIMI ME UJË, MENAGJIMI I HEDHURINAVE TË NGURTA, HAPËSIRAT PËR PARKINGJE, ETJ.)

Të gjitha objektet e planifikuara në hapësirën e lagjes Medrese-Çamëria kyqen në rrjetet e infrastrukturës teknike (ujësjellës, kanalizim, rrjet elektroenergjetik, TK) sipas rregullave dhe standardeve teknike për këtë qëllim, dhe sipas kushteve të përcaktuara nga Kompanitë përkatëse (KUR Prishtina, KEK, PTK) dhe pëlqimit të tyre për kyqje në rrjet.





Të gjitha objektet duhet të kenë të hapësirat e dedikuara për deponimin e hedhurinave dhe në marrëveshje me kompaninë përkatëse (KUR Pastrimi) të bëjnë largimin e tyre për në deponinë rajonale.

Të gjitha objektet në lagjen Medrese-Çamëria duhet të ofrojnë sipërfaqe të mjaftueshme parkimi, konform parametrave të përshkruar me këtë plan. Objektet publike duhet të ofrojnë së paku 3 vendparkingje në parcelë (oborr) me qasje nga rruga, ku njëra nga këto tri parkingje duhet të jetë e standardit për veturat e personave me aftësi të kufizuar.

### 3.30 KUSHTET PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE TREGTARE, PUNËTORIVE, DEPOVE APO FABRIKAVE

#### Ndërtesat afariste / tregtare

Hapësirat afariste në kuadër të ndërtesave të banimit duhet të kenë raport ~20% të sipërfaqes bruto të ndërtesës së banimit.

Ndërtesat afariste duhet të kenë lartësi të pastër prej 3.6 m dhe duhet të sigurohet hapësira për 1 vendparkim në 30m<sup>2</sup>.

#### Punëtori / depo / fabrika (industri)

Objektet për punëtori apo industry mund të ndërtohen në lagjen Medrese- Çamëria me kusht që:

Vendosen brenda parametrave për vendosjen e hapësirave afariste ~20% të sipërfaqes bruto të ndërtimit brenda bllokut.

Nuk rrezikojnë mjedisin apo shkaktojnë ndotje dhe përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në 3.10 dhe 3.15.

### 3.31 KUSHTET PËR VENDOSJEN E OBJEKTEVE ME KARAKTERISTIKA TË VEÇANTA ARKITEKTONIKE TË DIZAJNUARA PËR QËLLIME TË VEÇANTA

Kushtet e përgjithshme për vendosjen e objekteve me karakteristika të veçanta arkitektonike të dizajnuara për qëllime të veçanta janë të njëjta me ato të prezentuara në këtë plan për objektet e përgjithshme, dhe variojnë sipas destinimit dhe parametrave të bllokut përkatësisht në të cilin parashihet të ndërtohet objekti me karakteristika të veçanta.

Kushtet e veçanta duhet të përcaktohen me detyrë konkrete projektuese nga organi projektues, investitori ose autoritetet komunale (ose të gjitha këto së bashku) me kusht që nuk dëmtojnë parametrat e përgjithshëm të rregullimit të lagjes të prezentuar në këtë plan, si dhe respektojnë kushtet për mbrojtje të mjedisit (3.10) dhe për mbrojtje nga ndotja dhe fatkeqësitë (3.15).



### 3.32 KUSHTET PËR NDËRTIMIN E OBJEKTEVE ME RËNDËSI STRATEGJIKE

Në rast të evidentimit të interesit për ndërtimin e objekteve që kategorizohen në objekte me rëndësi strategjike për komunën e Prishtinës apo Republikën e Kosovës, në lagjen Medrese-Çamëria, kushtet për ndërtimin e objekteve të tilla përcaktohen nga autoriteti përgjegjës për ndërtimin e objektit në fjalë.

Kusht për ndërtimin e objekteve me rëndësi strategjike është që ato të respektojnë kushtet për mbrojtje të mjedisit (3.10) dhe për mbrojtje nga ndotja dhe fatkeqësitë (3.15).



## 4 VLERËSIMI I NDIKIMIT NË MJEDIS - VNM

VNM i Planit Rregullues Urban për lagjen “Medrese-Çamëri” konform Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis bëhet me qëllim të parandalimit dhe zvogëlimit të ndikimit negativ në mjedis të këtij projekti. Ky raport identifikon ndikimet eventuale në mjedis të projektit në fjalë.

### 4.1 INFRASTRUKTURA LIGJORE NË FUSHËN E MJEDISIT

Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligje që rregullojnë mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës dhe ato që ndërlidhen me ndikimet në mjedis. Janë rreth 30 ligje të tilla të miratuara që prekin këtë fushë, por ligjet më të rëndësishme për mjedisin që zbatohen në Komunën e Prishtinës janë:

- Ligji për mbrojtjen e mjedisit;
- Ligji për ujërat e Kosovës;
- Ligji për mbeturinat;
- Ligji për vetëqeverisje lokale;
- Ligji për mbrojtjen e natyrës;
- Ligji për planifikimin hapësinor;
- Ligji për pyjet e Kosovës; etj.

### 4.2 MBROJTJA E AJRIT

Qëllimi i mbrojtjes së ajrit nga ndotja është ruajtja e shëndetit të njerëzve, botës shtazore dhe bimëve. Hulumtimet e ndryshme dhe të dhënat nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike mbi gjendjen e ajrit në Komunën e Prishtinës, tregojnë që gjendja e ajrit në komunë është në kufirin e epërm të lejuar të disa parametrave përcaktues të ndotjes së ajrit.

Përmes planifikimit të një rrjeti të trafikut, vendeve për parkim, qasjes së lehtësuar, zgjerimit të zonave për këmbësor është tentuar të arrihet zgjidhje që ndikon në zvogëlimin e prezencës së gazrave të liruar të dëmshëm për ambient.

Mirëmbajtja e rregullt e hapësirës publike po ashtu përmirëson kushtet higjienike—pastërtinë e ajrit dhe të tokës.


### 4.3 RRJETI I FURNIZIMIT ME UJË, RRJETI I KANALIZIMIT

Plani parasheh zëvendësimin e gypave të vjetër të rrjetit të ujësjellësit që do të ndikojë në kursimin e ujit, cilësinë e tij për pije poashtu edhe shkallën e sigurisë nga ndotja e ujit.

Ujërat e zeza parashihet të trajtohen në impiantin rajonal i cili përfshinë tërë territorin e Prishtinës dhe pritet të ndërtohet në dalje të qytetit, më saktësisht në verilindje të qytetit të Fushë Kosovës. Kjo do të zvogëlojë shkallën e rrezikut për ndotje të ujërave nëntokësore etj.

### 4.4 TRAJTIMI I MBETURINAVE

Plani i menaxhimit të mbeturinave është i hartuar në nivel të qytetit. Shërbimi i ndërmarrjeve Publike në Prishtinë dhe në këte lagje duhet të decentralizohet për të



rritur nivelin e cilësisë së shërbimeve. Duhet të aplikohet sistemi i ndarjes së mbeturinave organike dhe inorganike dhe në mënyrë të veçantë ndarja e materieve të rrezikshme. Largimi i mbeturinave të bëhet konformë sasisë së hedhurinave që krijohen në këte lagje.

Në pika të ndryshme duhet përcaktuar hapësirat për deponim kohëshkurtër të mbeturinave në kontejnerë. Kjo hapësirë edhe pse duhet të ketë qasje të lehtë nga rruga, duhet të jetë vizualisht e izoluar (me tampon gjelbërimi, gardh). Kontejnerët e mbeturinave nuk lejohet të pengojnë trafikun e këmbësorëve ose të veturave.

Materiali ndërtimor i ndërtesave të rrënuara (përveç atij që përmban katran), duhet shfrytëzuar si material inert për sanim të deponive të mbeturinave.

Sipas analizës që kemi bërë në lagje rrjedh që totali i numrit të kontejnerëve të rritet në 50 varësisht nga dendësia urbane e planifikuar.

Tab.13 Sasia e mbeturinave

| teresia | tipi i shfrytëzimit            | Sip. (Ha)    | Perqindja %    | ISHP | ISD | Sip. Ndert perdhese (m <sup>2</sup> ) | Sip. Totale ndertimi (m <sup>2</sup> ) | Sip. Gjelberimi (Ha) | nr. ban.      | nr. ban/ha. | nr. kontejnerve |
|---------|--------------------------------|--------------|----------------|------|-----|---------------------------------------|--|----------------------|---------------|-------------|-----------------|
| A       | Zone Mikse (ZM)                | 45.16        | 46.14%         | 0.4  | 2.0 | 180,656                               | 903,280                                | 18.07                | 28,792        | 638         | 46              |
| B       | zone Banimi (ZB)               | 11.79        | 12.05%         | 0.4  | 0.9 | 47,170                                | 106,132                                | 5.90                 | 1,685         | 143         | 3               |
|         | <b>Siperfaqe Banimi:</b>       | <b>56.96</b> | <b>58.18%</b>  |      |     | <b>227,826</b>                        | <b>1,009,412</b>                       | <b>23.96</b>         | <b>30,477</b> | -           | <b>49</b>       |
| C       | Zone e shpërbimeve publike(ZP) | 23.56        | 24.07%         | /    | /   | 31,518                                | 84,154                                 | 18.36                | 0             | -           | 29              |
|         | <b>Siperfaqe e rrugëve:</b>    | <b>17.38</b> | <b>17.75%</b>  |      |     |                                       |  |                      |               |             |                 |
|         | <b>totali:</b>                 | <b>97.89</b> | <b>100.00%</b> |      |     | <b>259,343</b>                        | <b>1,093,565</b>                       | <b>42.33</b>         | <b>30,477</b> | <b>260</b>  | <b>78</b>       |

## 4.5 MBROJTJA NGA ZHURMA

Mbrojtja nga zhurma është paraparë përmes specifikimit të kushteve për ndërtim, planifikimit të brezave të gjelbrimit të lartë, dhe në raste specifike aplikimit të murit mbrojtës nga zhurma.

Lokacioni ka destinim kryesisht të banimit, por lejohen veprimtari me destinim-pune, veprimtari të qeta, por të cilat janë brenda kufirit të zhurmës, 45 db-natën dhe 55 db ditën. Përgjatë rrugëve përmbledhëse dhe rrugëve lokale parashihet mbjellja e drurëve përgjatë shiritit të gjelbrimit me qëllim të zbutjes së zhurmës. Përgjatë hekurudhës, në kufirin perëndimor të lagjes parashihet përveç gjelbrimit të lartë të aplikohet edhe muri i dizajnuar për mbrojtje nga zhurma.

## 4.6 MBROJTJA NGA ZJARRI


Më qëllim të mbrojtjes nga zjarri, ndërtesat fqinje do të jenë të larguara më së paku 4.0 m, ose të ndara mes veti me mur mbrojtës nga zjarri me kohëzgjatje min. 90 min.

Me qëllim të shpëtimit të njerëzve nga zjarri duhet që të gjitha ndërtesat të kenë mundësinë e qasjes me makinën e zjarrfikësit.

Me këtë qëllim janë planifikuar edhe hidrantë. (shih kapitullin "Infrastruktura teknike")

- të detyrohen ndërtuesit në planifikimin e ndriçimit emergjent
- të pengohet parkimi në vendet ku ka hidrante

me plane të nivelit më të ulët të zgjidhen depërtimet për zjarrfikës, d.m.th të evitohen blloqet e mbyllura.



#### 4.7 MBROJTJA E NJERËZVE

Bodrumet e disa ndërtesave duhet të ndërtohen ashtu që në rast nevoje të shfrytëzohen si strehimore për njerëz.

Strehimoret e mbrojtjes primare duhet të kenë rezistencë 100-300kPa.

Strehimoret ndërtohen duke pasur parasysh destinimin e objektit, numrin e njerëzve që jetojnë apo punojnë, kushtet hidro-gjeologjike e të ngjashme.

Strehimoret nuk ndërtohen nëse:

- është siguruar strehimi i njerëzve në strehimore ekzistuese
- ndërtesa është e shfrytëzimit të përkohshëm
- në hapësira me kushte të papërshtatshme hidro-gjeologjike

Strehimoret duhet të projektohen si hapësira me destinim të dyfishtë.

Locimi i strehimoreve duhet të jetë i tillë që të mundësojë hyrjen dhe daljen edhe në rast të rrënimit të objekteve.

Zonat për ndërtim të obligueshëm të strehimoreve duhet të parashihen me planin zhvillimor të qytetit, ose të sillen me vendim të Kuvendit Komunal.



## 5 DISPOZITAT E IMPLEMENTIMIT

### 5.1 DISPOZITAT E PËRGJITHSHME E RREGULLIMIT

#### 5.1.1 Ndarja në tërësi urbane

- Lagja Medrese-Çamëri ndahet në 3 tërësi hapësinore dhe ato pastaj në blloqe urbane;
- Secila tërësi apo bllok përkohësisht është emërtuar me shkronja të alfabetit: Tërësia A, tërësia B dhe tërësia C;
- Sistematizimi zyrtar (kodim zyrtar) i tërësive hapësinore është i domosdoshëm, dhe mbetet përgjegjësi e autoriteteve komunale;

### 5.2 DISPOZITAT LIDHUR ME PËRGJEGJËSITË, BASHKËPUNIMIN DHE PJESËMARRJEN

#### Vendimarrja

- Vendimarrja për zhvillimin e lagjes duhet të bëhet nga Asambleja Komunale.

#### Themelimi i grupit punues

- Grupin punues e themelon kryetari i Komunës dhe duhet të përbëhet prej drejtorit të Drejtoratit për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, drejtorit të Drejtoratit për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, drejtorit të Drejtoratit për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim, përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe përfaqësues të pronarëve të tokës.

#### Përmirësimi i përfshirjes, pjesëmarrjes dhe vetëdijesimi


- Zbatimi dhe përforcimi i planit rregullues urban për lagjen Medrese-Çamëri do të jetë isukseshëm vetëm nëse komuna do të krijojë përkrahje të mjaftueshme dhëmirebesim midis investitorëve dhe pronarëve të saj për këto aktivitete.

#### Vlerësimi dhe monitorimi

- Plani Rregullues Urban do të vlerësohet në mënyrë të rregullt, një herë në dy vjetpërveç nëse ka ndonjë kërkesë të veçantë. Po ashtu zhvillimet aktuale, nevojat e investitorëve dhe faktorë të tjerë ekonomik duhet të merren në konsideratë.
- Çdo pesë vite plani duhet të rishikohet në tërësi.

#### Bashkëpunimi me pronarët privat

- Krijimi i marrëveshjes me pronarët privat rreth blerjes së pronave nga Komuna nëseekziston nevoja;
- Krijimi i marrëveshjes me pronarët privat rreth mundësisë së riparcelizimit ;
- Krijimi i marrëveshjes me pronarët privat rreth blerjes së pronave nga ndërmarrjet private;



### Bashkëpunimi me komunitetin e biznesit

- Marrëveshjet me ndërmarrjet private rreth stimulimit të investimit (kushte të volitshme për investim)
- Marrëveshjet me ndërmarrjet private rreth mundësisë së riparcelizimit

## 5.3 DISPOZITAT E FUNDIT DHE KALIMTARE

### 5.3.1 Aprovimi i planit

- Aprovimi i planit bëhet nga Asambleja Komunale e Prishtinës menjëherë pas përfundimit të shqyrtimit publik;

### 5.3.2 Vlefshmëria

- Ky plan ka vlefshëri 5 vite nga data e aprovimit të planit
- Pas 5 viteve nga data e aprovimit të planit bëhet revidimi i planit



## 6 PARAMASA DHE PARALLOGARIA E INFRASTRUKTURËS

### 6.1 SISTEMI RRUGOR

| Nr | Emri i rrugës                   | Gjeresia [m] | Gjatesia [m] | Siperfaqja [m <sup>2</sup> ] |
|----|---------------------------------|--------------|--------------|------------------------------|
| 1  | "Bajram Bahtiri"                | 18           | 1991         | 35838                        |
| 2  | "Llapit"                        | 10.5         | 473.87       | 4975.635                     |
| 3  | "Haxhi Zeka"                    | 10.5         | 2347.67      | 24650.535                    |
| 4  | "Mustafe Veselaj"               | 9.0          | 336.14       | 3025.26                      |
| 5  | "Myrvete Maksutaj"              | 9.0          | 320.75       | 2886.75                      |
| 6  | "Abedin Reka"                   | 9.0          | 329.55       | 2965.95                      |
| 7  | "e Re"                          | 9.0          | 280.78       | 2527.02                      |
| 8  | "Murat Gjakti"                  | 9.0          | 383.84       | 3454.56                      |
| 9  | "e Re"                          | 9.0          | 329.34       | 2964.06                      |
| 10 | "e Re"                          | 9.0          | 323.7        | 2913.3                       |
| 11 | "e Re"                          | 9.0          | 303.85       | 2734.65                      |
| 12 | "e Re"                          | 9.0          | 176.26       | 1586.34                      |
| 13 | "e Re"                          | 8.0          | 668.57       | 5348.56                      |
| 14 | "Evlija Qelebi" dhe shtesat     | 8.0          | 764.32       | 6114.56                      |
| 15 | "Lidhja e Pizrenit" dhe shtesat | 8.0          | 602.47       | 4819.76                      |
| 16 | "e Re"                          | 8.0          | 1226.5       | 9812                         |
| 17 | "e Re"                          | 8.0          | 921.28       | 7370.24                      |
| 18 | " e Re"                         | 8.0          | 1881.36      | 15050.88                     |
| 19 | " e Re"                         | 8.0          | 1081.18      | 8649.44                      |
| 20 | " e Re"                         | 8.0          | 805.04       | 6440.32                      |
|    |                                 |              | 15547.47     | 154.127.82 m <sup>2</sup>    |


|                    |                           |
|--------------------|---------------------------|
| Siperfaqja Totale: | 154.127.82 m <sup>2</sup> |
| Çmimi njësi:       | 18€/m <sup>2</sup>        |
| GJITHSEJ:          | 2.774.300.76€             |





## 6.2 SISTEMI I NGROHJES

| Nr.             | Emërtimi I materialit  | Njësia         | Sasia | Çmimi (€) | Shuma(€)             |
|-----------------|--|----------------|-------|-----------|----------------------|
| 1               | Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave të çelikut me paraizolim për ngrohje qendrore - prodhim nga ISOPLUS - Gjermani ose ngjashem - me këto dim.: |                |       |           |                      |
|                 | DN 50 / Ø125 (Ø 60.3 x 2.9 mm)   | m              | 264   | 30        | 7920                 |
|                 | DN 65 / Ø140 (Ø 76.1 x 2.9 mm)   | m              | 540   | 40        | 21600                |
|                 | DN 80 / Ø160 (Ø 88.9 x 3.2 mm)   | m              | 1008  | 55        | 55440                |
|                 | DN 100 / Ø200 (Ø 114.3 x 3.6 mm)   | m              | 1368  | 73        | 99864                |
|                 | DN 125 / Ø225 (Ø 139.7 x 3.6 mm)   | m              | 1800  | 89        | 160200               |
|                 | DN 150 / Ø250 (Ø 168.3 x 4.0 mm)   | m              | 2076  | 114       | 236664               |
|                 | DN 200 / Ø315 (Ø 219.1 x 4.5 mm)   | m              | 2556  | 230       | 587880               |
|                 | DN 250 / Ø400 (Ø 273.0 x 5.0 mm)   | m              | 1968  | 290       | 570720               |
|                 | DN 350 / Ø500 (Ø 355.6 x 5.6 mm)   | m              | 480   | 356       | 170880               |
|                 | DN 400 / Ø560 (Ø 406.4 x 6.3 mm)   | m              | 840   | 385       | 323400               |
|                 | DN 450 / Ø630 (Ø 457.2 x 6.3 mm)   | m              | 480   | 524       | 251520               |
|                 | DN 500 / Ø670 (Ø 508.0 x 6.3 mm)   | m              | 480   | 680       | 326400               |
| 2               | Fiting dhe material harxhues (kthesa, T-pjesë, redukues, vazhduese, unaza, Polyol, Isocyanat etj), paguhet 50% nga pozicioni 1                         | %              | 0.5   | 2812488   | 1406244              |
| 3               | Ventil sferik me fllansha, kontraflansha, bulona dhe diktuna , prodhim nga VAPORUSA - Italy ose ngjashem - me dimensione si vijon:                     |                |       |           |                      |
|                 | DN 50  | copë           | 8     | 95        | 760                  |
|                 | DN 65  | copë           | 8     | 120       | 960                  |
|                 | DN 80  | copë           | 18    | 165       | 2970                 |
|                 | DN 100   | copë           | 36    | 200       | 7200                 |
|                 | DN 125   | copë           | 22    | 240       | 5280                 |
|                 | DN 150   | copë           | 18    | 320       | 5760                 |
| 4               | Hapja e kanaleve me dimensione adekuate për vendosjen e rrjetit gypor  | m <sup>3</sup> | 17500 | 3         | 52500                |
| 5               | Furnizimi dhe mbulimi i gypave me rerë të imët ( nën dhe mbi gypa Ø = 10 cm)   | m <sup>3</sup> | 5800  | 18        | 104400               |
| 6               | Hudhja dhe ngjeshja e dheut në kanal   | m <sup>3</sup> | 11000 | 4         | 44000                |
| 7               | Largimi i dheut të tepërt deri në vendin e caktuar   | m <sup>3</sup> | 13500 | 3         | 40500                |
| 8               | Punimi I pushtave nga beton- armeja me dimensione 2 x 2 x 2 m (komplet)  | copë           | 55    | 1680      | 92400                |
| 9               | Shirit sinjalizues - 50 cm nën sipërfaqen e tokës  | m              | 7500  | 2         | 15000                |
| 10              | Transporti paguhet 3.5% e të gjitha pozicioneve (1 - 9)  | %              | 0.035 | 4590462   | 160666.17            |
| 11              | Punët e parapara paguhet 5% e pozicioneve 1 - 9  | %              | 0.05  | 4590462   | 229523.1             |
| 12              | Shqyrtimi I rrjetit me ujë të ftohtë 2.5% nga poz. 1 - 9   | %              | 0.025 | 4590462   | 114761.55            |
| 13              | Shqyrtimi I rrjetit me ujë të ngrohtë 3% nga poz. 1 - 9  | %              | 0.03  | 4590462   | 137713.86            |
| <b>GJITHSEJ</b> |  |                |       |           | <b>5.233.127.00€</b> |



### 6.3 RRJETI ELEKTROENERGJETIK

|           |   | Njësia | Sasia  | Çmim nj          | Çmimi i tërë        |
|-----------|---|--------|--------|------------------|---------------------|
|           | <b>INFRASTRUKTURA ELEKTRIKE DHE TELEKOMUNIKUESE</b>                       |        |        | <b>Euro</b>      | <b>Euro</b>         |
| 1         | Trafostacione te reja 20/0.4 kV/kV S=400 KVA                              | copë   | 1      | 25000            | 25,000.00           |
| 2         | Trafostacione te reja 20/0.4 kV/kV S=630 KVA                              | copë   | 10     | 30000            | 300,000.00          |
| 3         | Trafostacione te reja 20/0.4 kV/kV S=1000 KVA                             | copë   | 20     | 35000            | 700,000.00          |
| 4         | Kablllo 10(20)kV në PVC gypa. Kablllo eshte e tipit XHP 49A 1x240 mm2     | km     | 32     | 50000            | 1,600,000.00        |
| 6         | Kablllo nentoksore për ndriçim publik 1kV, të tipit PP00 4x25mm2          | km     | 54     | 20000            | 1,080,000.00        |
| 7         | Shtylla metalike për ndriçim publik me lirë të njëfishtë, të lartësisë 9m | copë   | 950    | 300              | 285,000.00          |
| 8         | Llampa të Na 250 W për ndriçim publik                                     | copë   | 950    | 150              | 142,500.00          |
| 9         | kablllo me fije optike per telekomunikacion                               | km     | 38.000 | 25000            | 950,000.00          |
| 11        | Kuadro shpërndarëse për telekomunikacion me numra telefonik.              | copë   | 42     | 17500            | 735,000.00          |
| <b>I</b>  | <b>Gjithsej ElektriKa</b>   |        |        |                  | <b>4,332,500.00</b> |
| <b>II</b> | <b>Gjithsej Telefonia</b>   |        |        |                  | <b>1,965,000.00</b> |
|           |   |        |        | <b>GJITHSEJ:</b> | <b>6,297,500.00</b> |



## 6.4 UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI

|            | <i>Përshkrimi</i>   | <i>Njësia</i> | <i>Sasia</i> | <i>Çmimi njësi</i> | <i>Çmimi total</i>  |
|------------|---|---------------|--------------|--------------------|---------------------|
| <b>I</b>   | <b>UJËSJELLËSI</b>  |               |              |                    |                     |
|            | Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave PEHD 100 PN10 dhe pjesëve fazonike të duhura të ujësjellësit. Njëkëtë pozicion janë parapar: punët tokësore, lidhja dhe të gjitha pjesët fazonike të duhura për lidhje si dhe shqyrtimi në shtypje dhe dezinfektimi i rrjetit. |               |              |                    |                     |
|            | Φ 110 mm  | m             | 17671.00     | 30.00 €            | 530,130.00 €        |
|            | Φ 225 mm  | m             | 600.00       | 60.00 €            | 36,000.00 €         |
|            | Φ 250 mm  | m             | 360.00       | 80.00 €            | 28,800.00 €         |
|            |   |               |              |                    | <b>594,930.00 €</b> |
| <b>II</b>  | <b>KANALIZIMI FEKAL</b>   |               |              |                    |                     |
|            | Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave për kanalizimin fekal me material PESN 8 dhe pusetave. Në këtë pozicion janë parapar: punët tokësore, lidhjet me goma diktung, dhe ankerimi i gypave dhe pusetave si dhe testimi.  |               |              |                    |                     |
|            | Φ 200 mm  | m             | 5369.00      | 35.00 €            | 187,915.00 €        |
|            | Φ 250 mm  | m             | 1786.00      | 45.00€             | 80,370.00 €         |
|            | Φ 315 mm  | m             | 2036.00      | 50.00€             | 101,800.00 €        |
|            | Φ 400 mm  | m             | 2034.00      | 70.00€             | 142,380.00 €        |
|            | Φ 500 mm  | m             | 517.00       | 90.00€             | 46,530.00 €         |
|            |   |               |              |                    | <b>558,995.00 €</b> |
| <b>III</b> | <b>KANALIZIMI ATMOSFERIK</b>  |               |              |                    |                     |
|            | Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave për kanalizimin fekal me material PESN 8 dhe pusetave. Njëkëtë pozicion janë parapar: punët tokësore, lidhjet me goma diktung, dhe ankerimi i gypave dhe pusetave si dhe testimi.  |               |              |                    |                     |
|            | Φ 250 mm  | m             | 6441.00      | 35.00€             | 225,435.00 €        |
|            | Φ 315 mm  | m             | 2049.00      | 40.00€             | 81,960.00 €         |
|            | Φ 400 mm  | m             | 4639.00      | 60.00€             | 278,340.00 €        |
|            | Φ 500 mm  | m             | 705.00       | 80.00€             | 56,400.00 €         |
|            | Φ 630 mm  | m             | 381.00       | 90.00€             | 34,290.00 €         |
|            |   |               |              |                    | <b>676,425.00 €</b> |


| <b>REKAPITULLIMI:</b> |                              |                       |
|-----------------------|------------------------------|-----------------------|
| <b>I.</b>             | <b>UJËSJELLËSI</b>           | 594,930.00 €          |
| <b>II.</b>            | <b>KANALIZIMI FEKAL</b>      | 558,995.00 €          |
| <b>III.</b>           | <b>KANALIZIMI ATMOSFERIK</b> | 676,425.00 €          |
|                       |                              | <b>1,830,350.00 €</b> |



## 6.5 REKAPITULIMI

Tab.14Rekapitulimi i fazave

|     |                                   |                        |
|-----|-----------------------------------|------------------------|
| I   | <b>SISTEMI RRUGOR</b>             | <b>2.774.300.76 €</b>  |
| II  | <b>SISTEMI I NGROHJES</b>         | <b>5.233.127.00€</b>   |
| III | <b>SISTEMI ELEKTROENERGJETIK</b>  | <b>6,297,500.00 €</b>  |
| IV  | <b>UJËSJELLËSI DHE KANALIZIMI</b> | <b>1,830,350.00 €</b>  |
|     | <b>TOTALI:</b>                    | <b>16.135.277.76 €</b> |



#### Literatura dhe ligjet e përdorura:

- Urbanistika 1, 2
- Osnovi urbanizma 1, 2, 3, 4
- Neufert, Architect's Data, Third Edition
- Prostorno planiranje, regionalni razvoj i zaštita životne sredine
- Parametri za planiranje i projektovanje stanovanja u gradskim naseljima
- Urbanisticki modeli gradskog stanovanja u niskim grupacijama
- Urbanizam – teorija prostornog planiranja i uredjenja naselja - Branko Maksimovic
- Norms and standards in urban development
- European standards for urban planning
- Urbanism - Dieter Prinz
- Urban Space - Rob Krier
- Plani Zhvillimor Strategjik - Prishtina 2004-2020
- [www.prishtina-komuna.org](http://www.prishtina-komuna.org)
- [www.mef-rks.org](http://www.mef-rks.org)
- Ligji për ndryshimin e ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003-14 (Ligji nr. 03/L-106)
- Ligjin për Planifikim Hapsinor (Ligji nr. 2003/14)
- Ligji për Rrugët (Ligji nr. 2003/11)
- Ligji për Hekurudhat e Republikës së Kosovës (Ligji nr. 03/L-076)
- Ligji për mbrojtjen e mjedisit (Ligji nr. 03/L-025)
- Ligji për energjinë elektrike
- Ligji për mbeturinat
- Ligji për mbrojtjen nga zjarri
- Ligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera
- Ligji për mbrojtje nga zhurma
- Ligji për trashëgiminë kulturore (Ligji nr. 02/L-88)
- Ligji për ndërtimin (Ligji 2004/15)
- Udhëzim administrativ - Për zbatimin e ligjit për planifikim hapësinor mbi elementet themelore të planit rregullues urban/2005




## Lista e tabelave

- Tab.1 Sipërfaqeve ekzistuese të ndërtimit
- Tab.2 Dendësia urbane dhe numri i kateve sipas PSZhUP
- Tab.3 Koeficientat e ndërtimit
- Tab.4 Të reshurat ne regjionin e Prishtines
- Tab.5 Normavat per llogaritje:
- Tab.6 Sipërfaqet e ndërtuara:
- Tab.7 Siperfaqet ekzistuese dhe te propozuara sipas destinimit
- Tab.8 Tabela e koeficientave
- Tab.9 Numri i objekteve edukativo-arsimore
- Tab.10 Normativa për infrastrukturën sociale
- Tab.11 Dendësia e blloqeve
- Tab.12 Largësia e gjelbrimit nga instalimet
- Tab.13 Sasia e mbeturinave
- Tab.14 Rekapitulimi i fazave

## Lista e figurave

- Fig.1 Qyteti i Prishtinës dhe pozita e lagjes Medrese-Çamëria
- Fig.2 Terreni i lagjes, profili i hekurudhës
- Fig.3 Pamje nga terreni, hulumtimi i profilin urban
- Fig.4 Plani Strategjik Zhvillimor Urban i Prishtinës
- Fig.5 Tërësia A - Zona mikse
- Fig.6 Tërësia B - zona e banimit
- Fig.7 Tërësia C - zona publike
- Fig.8 Destinimi i sipërfaqeve dhe tërësitë
- Fig.9 Udhëkryqi Rruga e Llapit – Rruga Bajram Bahtiri
- Fig.10 Opsioni 1 dhe 2
- Fig.11 Zgjidhja e aprovuar.
- Fig.12 Udhëkryqi
- Fig.13 Profili i rrugës kategoria I
- Fig.14 Profili i rrugës kategoria II
- Fig.15 Profili i rrugës kategoria III
- Fig.16 Profili i rrugës kategoria IV
- Fig.17 Profili i rrugës kategoria V
- Fig.18 Profili i lumit
- Fig.19 Profili i hekurudhës
- Fig.20 Rrjeti i trafikut urban
- Fig.21 Informata nga IMMR Prishtine
- Fig.22 Prerja terthore e tubacionit
- Fig.22 Objektet që atakojnë rrugët
- Fig.23 Riparcelimi i banimit individual
- Fig.24 Riparcelimi i banimit kolektiv
- Fig.25 Informata nga IMMR Prishtinë
- Fig.26 Koncepti i zhvillimit të lagjes
- Fig.27 Koncepti i zhvillimit të lagjes
- Fig.28 Koncepti i zhvillimit të lagjes
- Fig.29 Objektet që atakojnë rrugët



## B. PJESA GRAFIKE

- Harta 1. Ekstrakt nga Plani Strategjik
- Harta 2. Plani Kadastral
- Harta 3. Kategorizimi i rrugëve
- Harta 4. Profilet e Rrugëve
- Harta 5. Objektet që atakojnë rrugët
- Harta 6. Zgjidhja Urbane
- Harta 7. Riparcelimi
- Harta 8. Ujësjellësi
- Harta 9. Kanalizimi Fekal dhe atmosferik
- Harta 10. Rrjeti Elektroenergjetik
- Harta 11. Sistemi i Ngrohjes